

RAPORT
PËR PUNËN E FONDIT TË SIGURIMIT PENSIONAL
DHE INVALIDOR TË MAQEDONISË
PËR VITIN 2013

Shkup, Maj viti 2014

PËRMBAJTJA	
I. HYRJE	3
II. TË DHËNA STATISTIKORE	7
1. Numri i të siguruarve	7
2. Numri i përfituesve të pensionit	10
3. Përfitues me vlerë më të ulët të pensionit	15
4. Përfitues të kompensimit në të holla me aftësi të ngelur për punë	17
5. Përfitues të kompensimit në të holla për dëmtim fizik	19
6. Pjesëmarrja e të dalave për sigurim pensional dhe invalidor në bruto prodhimin vendor	19
III. HARMONIZIMI I PENSIONEVE	21
IV. PUNA FINANCIARE E FONDIT	26
1. Të hyrat e Fondit	29
2. Të dalat e Fondit	34
3. Rezultate financiare	41
4. Aksione dhe pjesë	41
5. Pagesa e kontributeve të prapambetura	42
6. Informimi	44
V. REALIZIMI I TË DREJTAVE DHE ZBATIMI I SIGURIMIT PENSIONAL DHE INVALIDOR	48
1. Zgjidhje e kërkesave në shkallën e parë	48
2. Puna e Seksionit për normativë, monitorim dhe zbatimin e dispozitave juridike dhe për të vepruarit sipas parashtresave në v.2013	52
3. Realizim i të drejtave sipas marrëveshjeve ndërkombëtare për sigurim social	54
4. Puna e Komisionit për vlerësimin e aftësisë për punë	59
5. Evidentimi amë	66
6. Pagesa e pensioneve	68
7. Puna pronësoresh - juridike	71
8. Organet e menaxhimit të Fondit	72
1. Këshilli drejtues	72
2. Drejtori	77
9. Shërbimi profesional i Fondit	78
1. Resurset njerëzore	78
2. Puna e Njësisë së aktuaristikës	82
3. Puna e Seksionit për revizion të brendshëm	84
4. Kontrolli buxhetor	88
5. Furnizime publike	90
6. Fondi solidar	93
10. Sistemi i informatikës	96
11. Ekonomizimi me pronën e Fondit dhe standardi shoqëror i përfituesve të pensionit	99
VI. PËRFUNDIM	103

RAPORT
PËR PUNËN E FONDIT TË SIGURIMIT PENSIONAL DHE INVALIDOR TË
MAQEDONISË PËR VITIN 2013

I. HYRJE

Sigurimi pensional dhe invalidor merr një vend të rëndësishëm në shoqërinë e përgjithshme të jetës sociale dhe politike në Republikën e Maqedonisë. Zhvillimi i sigurimit pensional dhe invalidor varet nga totali i lëvizjeve ekonomike, sociale dhe demografike në shoqëri, të cilët ndikojnë në sistemin e pensionimit të secilit vend, ndërsa rëndësia e tij shrehet përmes numrit të të siguruarve të cilët paguajnë kontribut për sigurim pensional dhe invalidor, numrit të përfituesve të pensionit, si dhe pjesëmarrjen e të dalave për sigurim pensional dhe invalidor në bruto prodhimin vendor.

Raporti për punën e Fondit të sigurimit pensional dhe invalidor të Maqedonisë përmban të dhëna të detajuara, individuale dhe gjithëpërfshirëse me arsyetime të detajuara dhe komente për rezultatet e realizuara nga zbatimi i sigurimit pensional dhe invalidor në Republikën e Maqedonisë. Gjithashtu, në Raportin vjetor janë paraqitur të dhënat statistikore për të drejtat e realizuara nga sigurimi pensional dhe invalidor, të dhënat financiare për punën e Fondit, të dhëna për zgjidhjen e të drejtave të sigurimit pensional dhe invalidor, evidentimi amë, standardi shoqëror i përfituesve të pensionit si dhe të dhëna të tjera. Aktivitetet e Fondit janë të shumta dhe të ndryshme dhe të njëjtat ndikojnë në popullatën më të moshuar në Vend, ndërsa në mënyrë indirekte edhe në anëtarët e familjeve të tyre.

Sistemi i sigurimit pensional dhe invalidor në Republikën e Maqedonisë zbatohet si sigurim i detyrueshëm pensional dhe invalidor në bazë të solidaritetit të

gjeneratave (Shtylla e parë), sigurim pensional i detyrueshëm me financim kapital (Shtylla e dytë) dhe sigurim pensional vullnetar (Shtylla e tretë) në bazë të kursimit të kapitalizuar individual.

Në shtyllën e parë dhe të dytë nga sistemi pensional, detyrimisht janë përfshirë të gjithë të punësuarit në bazë të marrëdhënies së punës dhe kryerjen e detyrës, ndërsa shtylla e tretë është në bazë vullnetare.

Punët të cilët janë në kompetencë të Fondit në vitin 2013 janë kryer me pëlqim të Ligjit për sigurim pensional të detyrueshëm me financim kapital, Ligjit për kontribute nga sigurimi i detyrueshëm për sigurim social, Buxhetit të Fondit dhe Programit për punën e Këshillit drejtues të Fondit.

Në kuadër të sigurimit pensional dhe invalidor, sigurimin e saj social e realizojnë mbi 303.091 përfitues të së drejtës nga sigurimi pensional dhe invalidor apo 14,7% nga gjithsej popullsia e Republikës së Maqedonisë për vitin 2013 (të vlerësuar 2.067.104), ndërsa pjesëmarrja e të dalave për sigurim pensional dhe invalidor (50.854,76 milion denarë) në bruto prodhimin vendor (474.196,00 milion denarë) arrin 10,7%, përderisa për pagesën e pensioneve 8,6%.

Organet qeverisëse të Fondit janë Këshilli drejtues dhe Drejtori i Fondit. Sipas nenit 156 paragrafi 2 nga Ligji për sigurim pensional dhe invalidor (Gazeta Zyrtare e RM-së nr.98/2012), Këshilli drejtues ka shtatë anëtarë të cilët i emëron Qeveria e Republikës së Maqedonisë, në periudhë prej katër vitesh. Nga numri i përgjithshëm i anëtarëve, dy anëtarë janë me propozim të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë dhe pesë anëtarë janë emëruar me propozim nga: Ministria e punës dhe politikës sociale një përfaqësues, nga Ministria e financave një përfaqësues, nga Sindikati reprezentativ anëtar i Këshillit ekonomik – social një përfaqësues; dhe nga Shoqata e lidhjes të pensionistëve të Maqedonisë një përfaqësues.

Gjithashtu, duhet që të nënvizohet se në vitin 2013 në mbështetje të nenit 120 nga Ligji për sigurim pensional dhe invalidor, shkalla e kontributit i cili është i shpërndarë për Shtyllën e dytë pensionale arrin 6% nga baza për pagesën e

kontributit e përcaktuar me ligj, ndërsa për të Parin shpërndahen 12% nga shkalla totale prej 18% nga kontributi i paguar.

Në fund të vitit 2013 numrit i përfituesve të pensionit arrinte në 526.909, përderisa numri i përfituesve të pensionit arrinte 291.821 përfitues (së bashku me përfituesit minimal të bujqve dhe përfituesit ushtarak) apo në lidhje me 1,80 të siguruar në 1 pensionist.

Në vitin 2013 Fondi realizoi gjithsej të hyra në shumë prej 51.070,23 milion denarë dhe gjithsej të dala në shumë prej 50.854,74 milion denarë, përkatësisht tepriçë e të hyrave prej 215,47 milion denarë. Në punën financiare të Fondit në vitin 2013 ndikonte mosrealizimi i indikatorëve të parashikuar makroekonomik. Nga këto arsye janë përgatitur ndryshime dhe plotësime në Buxhetin e RM-së.

Në vitin 2013, Fondi zbatoi harmonizim të pensioneve nga 1 janari për 1,15% dhe prej 1 korrikut për 0,75%, si dhe harmonizimin plotësues të pensioneve prej 5% përkatësisht 550 denarë në shumë nominale nga shkurti për të gjithë pensionistët të cilët kanë ndikim në mirëmbajtjen e vlerës reale të përfitimeve pensionale.

Me harmonizimin e zbatuar të pensioneve, pensioni mesatar në dhjetor të vitit 2013 (nga e drejta e punës) arriti në 11.819 denarë dhe në raport me vitin 2012 (11.016) është më e lartë për 7,3%, ndërsa së bashku me pensionet minimale bujqësore dhe ushtarake, pensioni mesatar në vitin 2013 arrinte në 11.845 denarë, ndërsa në vitin 2012 e njëjta arrinte 11.038 denarë dhe është e zmadhuar për 7,3%.

Edhe në vitin 2013, Fondi udhëheqte politikë restriktive kadrovike në mbështetje me masat anti krizë të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë që mos të pranohen punonjës të rinj në vendet e lira në bazë të pensionimit apo baza tjera në mbështetje të Ligjit për marrëdhënie pune.

Me zbatimin e Projektit për mbështetje teknike për dizejnjimin e proceseve të reja afariste për realizimin e të drejtës për pagesën e pensioneve, në vitin 2013 në mënyrë të konsiderueshme është i shkurtuar afati për zgjidhjen e të drejtave nga sigurimi pensional dhe invalidor dhe pagesën e pensioneve.

Fondi në vitin 2013 ka paguar pensione për 291.821 përfituesve të pensionit (ushtarake dhe minimale të bujqëve) me vlerë mesatare mujore të të dalave në shumë prej 3.401 milion denarë në neto shumën dhe 477 milion denarë kontribut për sigurim shëndetësor apo së bashku 3.848 milion denarë.

Gjatë vitit 2013, në mbështetje të dispozitave ligjore për shitjen e aksioneve dhe pjesëve të cilët i posedon Fondi i sigurimit pensional dhe invalidor i Maqedonisë, në bazë të Ligjit për transformimin e ndërmarrjeve me kapital shoqëror, Këshilli drejtues i Fondit, me propozim të Komisionit për aksione dhe pjesë, solli më shumë vendime për realizimin e shitjes të aksioneve dhe pjesëve të Fondit me miratim paraprak të sjellë nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë.

Edhe në vitin 2013, Fondi në mënyrë aktive morri pjesë në zbatimin e projektit të Qeverisë së Republikës të Maqedonisë për “Rekreacion të banjës klimatike për shfrytëzuesit e pensionit”. Parashtrimi i kërkesave si dhe përpunimi elektronik i të njëjtave zbatoheshin në Fond, mandej të njëjtat dorëzoheshin deri te Komisioni kompetent për rangimin e kërkesave të parashtruara pranë Ministrisë të Punës dhe Politikës Sociale. Pas rangimit të kryer nga ana e Komisionit deri te Fondi janë dorëzuar listat e shfrytëzuesve të pensionit të cilëve u është miratuar shfrytëzimi i shërbimit. Shërbimi profesional i Fondit me shkrim (përmes postës) dhe nëpërmjet telefonit të Kall qendrës, i njoftonte shfrytëzuesit e pensionit, ndërsa njëkohësisht listat janë shpallur edhe në ueb faqen e Fondit. Përfituesve të cilëve u ishte miratuar rekreacioni - klimaterik në banjë, Fondi ju lëshonte mjete për transport në llogarinë bankare që i kompensonte Ministria e Punës dhe Politikës Sociale.

II. TË DHËNA STATISTIKORE

1. Numri i të siguarve

Në bazë të evidentimit amë të Fondit për sigurim pensional dhe invalidor të Maqedonisë me gjendje në dhjetor të vitit 2013 janë aevidentuar 70.464 obligues dhe 526.909 të siguar me sigurim të detyrueshëm pensional dhe invalidor.

Tabela 1. Numri i të siguarve dhe obliguarve në dhjetor të vitit 2013;

Nr. rendor	Filiali	Të obliguar	Të siguar
1	Berovë	552	3.072
2	Manastir	4.098	27.203
3	Vallandovë	359	2.279
4	Veles	1.928	12.100
5	Vinicë	504	4.459
6	Gjevgjeli	1.501	10.221
7	Gostivar	3.085	12.201
8	Dibër	543	2.485
9	Dellçevë	735	5.234
10	Demir Hisar	264	1.405
11	Kavadar	1.650	11.253
12	Kërçovë	1.771	6.050
13	Koçanë	1.561	9.837
14	Kratovë	224	1.355
15	Kriva Pallankë	503	3.465
16	Krushevë	257	891
17	Kumanovë	3.645	20.956
18	Makedonski Brod	276	1.112
19	Negotinë	917	5.153
20	Ohër	2.570	15.598
21	Prilep	3.260	20.118
22	Probishtip	361	3.384
23	Radovish	1.051	4.938
24	Resnjë	494	2.910
25	Shën Nikollë	841	4.207
26	Strugë	2.262	9.826
27	Strumicë	3.082	19.235
28	Tetovë	4.496	24.034
29	Shtip	1.877	21.024
30	Shkup	25.797	260.904
Gjithsej		70.464	526.909

Nga gjithsej 70.464 i të siguarve e teritorit të qyteit të Shkupit janë 25.797 apo 36,6%, ndërsa nga numri i të siguarve 526.909 në Shkup janë të regjistruar 260.904 apo 49.5%.

Sipas të dhënave të Fondit, numri i të siguarve (gjendja në dhjetor të vitit 2013) për të cilët paguhet kontribut arrin 485.567 apo 92,2% nga gjithsej numri i të siguarve (526.909). Krahasimi në mes të siguarve të cilët paguajnë kontribut nga sigurimi i punës dhe gjithsej numrit të përfituesve të pensionit (289.114 pa pensione ushtarake dhe të bujqëve) arrin 1,6 të punësuar në një përfitues të pensionit, ndërsa krahasimi mes numrit të përgjithshëm të të siguarve dhe përfituesve të pensionit arrin 1,80 të siguar në 1 përfitues të pensionit.

Tabela 2: Numri i shfrytëzuesve të pensionit dhe numri i personave të punësuar


Viti	Numri i të punësuarve	Numri i përf. të pensionit (pa pens. mini.bujq. dhe ushtarake)	Numri i përfitues të pensionit në 1000 të punësuar	Numri i të punësuarve në 1 përfitues të pensionit
1991	534.887	180.749	338	3,0
1992	531.083	193.294	364	2,7
1993	503.010	210.537	418	2,4
1994	468.632	216.834	463	2,2
1995	427.658	219.307	513	2,0
1996	403.820	222.727	552	1,8
1997	381.723	227.099	596	1,7
1998	370.869	232.216	626	1,6
1999	374.025	235.839	631	1,6
2000	367.162	241.221	657	1,5
2001	351.009	247.200	704	1,4
2002	332.728	249.421	750	1,3
2003	321.105	254.262	775	1,3
2004	348.212	260.075	747	1,3
2005	348.500	265.152	761	1,3
2006	394.882	269.681	714	1,5
2007	424.338	272.386	693	1,6
2008	451.491	273.281	654	1,7
2009	475.780	273.977	576	1,7
2010	466.280	273.751	587	1,7
2011	489.608	277.441	567	1,8
2012	507.061	282.334	557	1,8

2013	526.909	289.114*	549	1,8
------	---------	----------	-----	-----


*pranë këtyre përfituesve të pensionit nga sigurimi i punës Fondi i sigurimit pensional dhe invalidor paguan edhe pensione ushtarake dhe të bujqëve dhe së bashku me ato numri i përgjithshëm i përfituesve të pensionit arrin 291.821 përfitues të pensionit.

Numri i të siguarve të regjistruar në dhjetor të vitit 2013 arrin 526.909 të siguar dhe i njëjti në krahasim me numrin e të siguarve në dhjetor të vitit 2012 prej 507.061 është zmadhuar për 19.848 të siguar, ndërsa numri i të siguarve për të cilët paguhet kontribut është zmadhuar prej 458.180 në vitin 2012 në 485.567 të siguar në dhjetor të vitit 2013 apo më shumë për 6,0%.

Numri i të siguarve, përfituesve të pensionit dhe krahasimi i tyre është i dhënë në grafikonin në vijim:



Struktura e të siguarve sipas gjinisë dhjetor viti 2013 është dhënë në grafikonin në vijim:



Nga numri i përgjithshëm i të siguarve në vitin 2013, 79.299 të siguar janë burra dhe 61.107 gra të moshës prej 40-50 vjet, ndërsa prej 50-60 moshën numri i të siguarve burra arrin 68.389 dhe gratë 44.871. Nga të dhënat e analizuara del se numri i përfituesve të pensionit pritet të shënon rritje në periudhën e ardhshme.

Struktura e pleqërisë e të siguarve në dhjetor të vitit 2013 është dhënë në grafikun në vijim:

2. Numri i përfituesve të pensionit

Numri i përfituesve të pensionit nga sigurimi i punës, me gjendje më 31.12.2013 arrin 289.114 përfitues, prej të cilëve 169.362 përfitues të pensionit të pleqërisë apo 58,6% nga gjithsej numri i përfituesve të pensionit; 42.741 përfitues të pensionit invalidor apo 14,8% dhe 77.011 përfitues të pensionit familjar apo 26,6%.

Tabela 3: Numri i përfituesve të pensionit në dhjetor të vitit 2012 dhe 2013

Lloji i pensionit	Përfitues të pensionit 31.12.2012	Përfitues të pensionit 31.12.2013	Rritje/reduktim	Indeks 2013/2012
Старосна	162.086	169.362	7.276	104,5
Pleqërisë	43.648	42.741	-907	97,9
Invalidor	76.600	77.011	411	100,5
Familjarë	1.953	1.827	-126	93,5
Bujqësore	1.124	880	-244	78,3
Gjithsej pensione:	285.411	291.821	6.410	102,2

Numri i përfituesve të pensionit të sigurimit të punës në vitin 2013 është i zmadhuar për 6.780 përfitues në raport me vitin 2012, gjegjësisht për 2,4% nga gjithsej numri i përfituesve të pensionit, si rezultat i rritjes së numrit të kërkesave të parashtruara për realizimin e të drejtës të pensionit të pleqërisë.


Rritja e numrit të përfituesve të pensionit në vitin 2013 është realizuar te përfituesit e pensionit të pleqërisë për 7.276 përfitues të rinj apo për 4,5%, tek përfituesit e pensionit invalidor është shënuar ulje për 907 përfitues, apo 2,1% dhe tek përfituesit e pensionit familjar ka rritje të 411 përfituesve të rinj apo 0,5% në raport të të njëjtëve në vitin 2012.

Në Fond paguhen pensione edhe për 1.827 përfitues të pensionit ushtarak dhe 880 përfitues të pensionit minimal bujqësor, me të cilët numri i përgjithshëm i përfituesve të pensionit në fund të vitit arrin 291.821 përfitues. Pranë kësaj Fondi paguan edhe kompensim për dëmtim fizik për 11.153 përfitues prej të cilëve 2.008 janë përfitues të dëmtimit fizik si e drejtë e vetme nga sigurimi pensional dhe invalidor.

Gjithsej numri i përfituesve të pensionit në vitin 2013 (së bashku me pensionet minimale ushtarake dhe bujqësore) është më e madhe për 6.410 përfitues të pensionit në raport me vitin 2012 apo 2,2% edhe atë, për shkak të reduktimit të pensioneve minimale të bujqëve për 244 përfitues dhe për 126 përfitues të pensioneve ushtarake. Këto përfitues edhe në të ardhmen do të zvogëlohen me

defluks natyror për shkak se këto përfitues të drejtën e tyre e kanë realizuar sipas dispozitave ligjore të cilat tanimë nuk zbatohen, ndërsa të drejta të reja nuk realizohen.

Struktura e përfituesve të pensionit sipas llojit të pensionit paraqitet në vijim:



Fluksi i përfituesve të rinj të pensionit të pleqërisë prej vitit 1994 deri në vitin 2013 është dhënë në grafikonin në vijim:





Tabela 4: Shkalla e rritjes të përfituesve të pensionit prej vitit 1991 - 2013 sipas llojit të pensionit

Periudha	Përfitues të rinj të pensionit të pleqërisë	Përfitues të rinj të pensionit invalidor	Përfitues të rinj të pensionit familjar	Gjithsej
1992-1991	7,8	7,4	5,0	6,9
1993-1992	11,6	6,9	5,2	8,9
1994-1993	2,5	3,7	3,5	3,0
1995-1994	-0,3	2,3	3,3	1,1
1996-1995	0,7	2,0	3,0	1,6
1996-1991	23,6	24,1	21,7	23,2
1997-1996	1,0	3,1	3,1	2,0
1998-1997	0,9	3,7	3,0	2,3
1999-1998	1,2	1,7	2,3	1,6
2000-1999	3,0	0,9	2,0	2,3
2001-2000	3,3	0,1	2,8	2,5
2002-2001	1,0	-0,2	1,5	0,9
2003-2002	2,6	-0,5	2,6	1,9
2004-2003	3,6	-1,2	2,4	2,3
2005-2004	3,6	-2,7	2,1	2,0
2006-2005	2,8	-1,6	1,8	1,7
2006-1996	25,5	4,1	26,1	21,1
2007-2006	2,2	-2,7	1,1	1,0
2008-2007	-0,3	1,1	1,0	0,3
2009-2008	0,3	-1,3	1,2	0,3
2010-2009	1,2	-3,8	-0,3	-0,1
2011-2010	2,7	1,9	1	2,1
2012-2011	3,9	-2,8	0,1	2,9
2013-2012	4,5	-2,1	0,5	2,4

Rritja e numrit të përfituesve të pensionit prej vitit 1992 – 2013 është paraqitur në grafikun në vijim:




Fluksi i përfituesve të pensionit invalidor edhe në vitin 2013 u reduktua si edhe në vitet e mëparshme për shkak të ndryshimeve në ligjin për sigurim pensional dhe invalidor.

Tabela 5: Lëvizja e numrit të përfituesve të pensionit sipas viteve:

Viti	Pensioni i pleqërisë	Pensioni invalidor	Pensioni familjar	Gjithsej
1991	94.676	38.206	47.867	180.749
1992	102.021	41.030	50.243	193.294
1993	113.799	43.867	52.871	210.537
1994	116.617	45.472	54.745	216.834
1995	116.241	46.509	56.557	219.307
1996	116.560	47.431	58.254	222.245
1997	118.148	48.909	60.042	227.099
1998	119.194	51.208	61.814	232.216
1999	120.574	52.060	63.205	235.839
2000	124.210	52.549	64.462	241.221
2001	128.322	52.619	66.259	247.200
2002	129.648	52.514	67.259	249.421
2003	133.008	52.237	69.022	254.267
2004	137.840	51.589	70.646	260.075
2005	142.827	50.180	72.145	265.152
2006	146.852	49.364	73.465	269.681
2007	150.075	48.364	74.257	272.696
2008	149.682	48.562	75.037	273.281

2009	150.092	47.947	75.937	273.976
2010	151.894	46.118	75.739	273.715
2011	156.016	44.895	76.530	277.441
2012	162.086	43.648	76.600	282.334
2013	169.362	42.741	77.011	289.114

Paraqitje grafike e lëvizjes së numrit të përfituesve të pensionit



Sipas grafikonit të dhënë, del se në rritje është numri i përfituesve edhe në vitin 2013 më shumë se gjysma apo (58,6%) nga gjithsej numri i përfituesve të pensionit janë përfitues të pensionit të pleqërisë, ndërsa pjesa tjetër i dedikohet përfituesve të pensionit familjar dhe invalidor.

3. Përfitues me vlerë më të ulët të pensionit

Tabela 6: Numri i lartësisë të pensionit të përfituesve me shumë më të ulët të pensionit

GRUPET	Numri i përfituesve	Shuma e pensionit (denarë)
Grupi i parë Pensione të realizuara deri më 31.12.1996	4.432	9.131,00
Pensione të realizuara nga 1997-2001	831	7.620,00
Pensione të realizuara pas 2001	3.877	8.129,00

Gjithsej grupi i parë (mbi 35 vjet meshkujt dhe mbi 30 vjet femrat)	9.140	
Grupi i dytë		
Pensione të realizuara deri 31.12.1996	6.479	8.900,00
Pensione të realizuara nga 1997-2001	1.833	7.092,00
Pensione të realizuara pas 2001	6.204	7.574,00
Gjithsej grupi i dytë (mbi 25 vjet meshkujt dhe mbi 20 vjet femrat)	14.516	
Grupi i tretë		
Pensione të realizuara deri 31.12.1996	16.452	8.604,00
Pensione të realizuara nga 1997-2001	6.989	6.562,00
Pensione të realizuara pas 2001	22.487	7.020,00
Gjithsej grupi i tretë (deri 25 vjet meshkujt dhe mbi 20 vjet femrat)	45.928	
Gjithsej	69.584	

Vlera më e ulët e pensionit përcaktohet në mënyrë të pavarur nga lartësia e pensionit e ndarë në bazë të kohëzgjatjes së stazhit pensional dhe pagave të realizuara. Ajo do të thotë se të siguruarit i garantohet vlera e pensionit që është më e lartë nga pensioni i ndarë nga kohëzgjatja e stazhit pensional si dhe pagat e realizuara. Instituti i vlerës më të ulët të pensionit është i bazuar në parimin e drejtësisë shoqërore si dhe lartësia e tij varet nga lartësia e kontributit të punës i shprehur në kohëzgjatjen e stazhit pensional edhe pse e njëjta është më e ulët, përfituesit i paguhet deri në pensionin më të ulët.

Në Fond, me gjendje më 31.12.2013 paguhet pension minimale i 69.584 përfituesve edhe atë: 45.928 përfitues apo 66,00% nga gjithsej numri i përfituesve të pensioneve minimale, nga grupi i tretë, përkatësisht me stazh më të ulët pensional (deri 25 vjet burrat, gjegjësisht deri 20 vjet gratë) në 14.516 përfitues nga grupi i dytë (mbi 25 vjet burrat dhe mbi 20 vjet gratë) apo 20,9% dhe në 9.140 përfitues të pensionit nga grupi i parë (mbi 35 vjet burrat dhe mbi 30 vjet gratë) apo 13,1% nga gjithsej numri minimal i pensioneve. Numri i përfituesve të pensionit me shumë më të ulët të pensionit në vitin 2013 krahasuar me vitin 2012 (75.078) është i reduktuar për 7,3% si rezultat i lartësisë të pensioneve me shumë më të lartë të përfituesve të

rinj të cilët të drejtën e pensionit e kanë realizuar në vitin 2013 dhe harmonizimin e pensioneve në vitin 2013, sidomos në mënyrë plotësuese në shkurt me shumë prej 550 denarë.

4. Përfitues të kompensimit në të holla me aftësi të ngelur për punë

Në Fond në fund të vitit 2013 kishte 117 përfitues, prej të cilëve 95 për kohën e pritjes të punësimit të tyre apo ndonjë pune tjetër përkatëse, 13 përfitues me orar të shkurtuar pune dhe 9 përfitues për shkak të të ardhurave të ulëta personale në punë tjetër përkatëse.

Pas hyrjes në fuqi të ndryshimeve të Ligjit për SPI ("Gazeta Zyrtare e RM-së" nr. 153/2007), të gjithë përfituesit e kompensimit në të holla në bazë të aftësisë së mbetur për punë të cilët kanë mbushur mbi 50 vjet jetë, u riemëruan në pension invalidor në bazë të aftësisë të zvogëluar për punë.


Përfitues (me ndryshim të caktuar në vend të punës apo orar të shkurtuar pune) të cilën nuk kanë mbushur 50 vjet jetë, mbetën edhe më tej të punojnë në punë tjetër apo me orar të shkurtuar pune dhe ende shfrytëzojnë kompensim në të holla.

Përfituesit e përhershëm të kompensimit në të holla deri në punësim, kompensimin e pagës për punë në tjetër vend pune dhe me orar të shkurtuar të punës, janë ata përfitues të cilët të drejtën e tyre e kanë realizuar para vitit 1997 dhe të njëjtën si të drejtë të fituar e realizojnë në Fond.

Tabela 7: Numri i përfituesve të kompensimit në të holla prej vitit 1997 – 2013

Lloji i të drejtës Viti	Koha e pritjes për punë	Orar i shkurtuar i punës	Pagë e ulët	Të ngelura	Gjithsej
1997	947	1196	1616	1016	4775
1998	946	972	1501	972	4391
1999	950	837	1364	910	4061
2000	897	573	1115	812	3397
2001	893	286	733	724	2636
2002	1035	200	616	676	2527
2003	1123	147	332	645	2247
2004	1180	130	265	488	2063
2005	1407	90	170	0	1667
2006	1659	63	106	0	1828
2007	1768	67	113	0	1948
2008	202	15	8	0	225
2009	183	14	9	0	206
2010	158	13	6	0	177
2011	145	16	10	0	171
2012	94	13	9	0	116
2013	95	13	9	0	117

Në tabelën vijuese grafikisht është paraqitur lëvizja e numrit të përfituesve të kompensimit në të holla sipas viteve.



Në vitin 2013 për përfituesit e kompensimit në të holla janë paguar mjete në shumë prej 7,08 milion denarë dhe janë në nivel të njëjtë me vitin 2012 ku janë paguar mjete në shumë prej 7,24 milion denarë.

5. Përfitues të kompensimit në të holla për dëmtim fizik

Përfitues të kompensimit në të holla për dëmtim fizik janë të siguruar tek të cilët është shkaktuar humbje, dëmtim më i madh apo aftësi e kufizuar më e rëndësishme.

Të drejtën e kompensimit në të holla për dëmtim fizik i siguruari e fiton pavarësisht nga ajo se a ka fituar dhe se a shfrytëzon ndonjë të drejtë tjetër nga sigurimi pensional dhe invalidor.

Numri i përfituesve të cilët pranojnë kompensim në të holla për dëmtim fizik në vitin 2013 arrinte 11.153 përfitues, prej të cilëve 2.008 përfitues e të drejtës së vetme dhe 9.145 përfitues me të drejtë pensioni. Numri i përfituesve për dëmtim fizik në vitin 2013, në krahasim me vitin 2012, është reduktuar për 212 përfitues apo për 1,87%.


6. Pjesëmarrja e të dalave për sigurim pensional dhe invalidor në bruto prodhimin vendor

Pjesëmarrja e të dalave për sigurim pensional dhe invalidor, bruto prodhimi vendor dhe krahasimi i tyre janë paraqitur në tabelën vijuese.

Tabela 8: Të dala për SPI, BPV dhe pjesëmarrja e të dalave në BPV

Viti	Gjithsej të dala për SPI	BPV	Pjesëmarrja e të dalave për SPI në BPV
	në milion denarë		
1990	60,87	506	12,0
1991	104	920	11,3
1992	1.337	11.794	11,3
1993	9.412	59.165	15,9
1994	18.445	146.409	12,6
1995	18.296	169.521	10,8
1996	18.925	176.444	10,7
1997	19.504	186.018	10,5
1998	20.533	194.979	10,5
1999	20.681	209.010	9,9
2000	22.942	236.389	9,7
2001	24.697	233.841	10,6
2002	25.889	243.970	10,6
2003	27.764	253.493	11,0
2004	29.117	258.751	11,3
2005	29.029	276.989	10,5
2006	31.207	298.140	10,5
2007	32.770	333.845	9,8
2008	38.733	405.014	9,6
2009	41.393	396.496	10,4
2010	42.507	425.628	10,0
2011	44.306	455.387	9,7
2012	46.227	476.072	9,7
2013	50.854	474.196	10,7

Pjesëmarrja e të dalave për sigurim pensional dhe invalidor në vitin 2013 arrin 10,7%.



Pjesëmarrja e të dalave për pensione në vitin 2013 arrin 8,6% në raport me BPV vitin e njëjtë.

III. HARMONIZIMI I PENSIONEVE

Në vitin 2013, harmonizimi i pensioneve u krye në mbështetje të nenit 37 nga Ligji për sigurim pensional dhe invalidor dhe nenit 247-a (Gazeta Zyrtare e RM-së) nga Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit të sigurimit pensional dhe invalidor.

Në mbështetje me dispozitat aktuale, ndërsa sipas të dhënave statistikore të shpallura nga ana e Entit shtetëror statistikor për rritjen e pagave të të punësuarve në Vend dhe Shpallja për lëvizjen e shpenzimeve për jetesë në Republikën e Maqedonisë, pensionet nga 1 janari i vitit 2013 u harmonizuan për 1,15% dhe nga 1 korriku për 0,75% dhe harmonizim plotësues prej 5% në shkurt të vitit 2013 apo gjithsej harmonizimi arrin 7%.

Harmonizimi i pensioneve në periudhën prej vitit 2001 deri në vitin 2013 është i dhënë në pasqyrën vijuese:

Табела бр.9: Извршено усогласување на пензиите од 2001-2013 година

Viti	Harmonizim i pensioneve më 1 janar	Harmonizim i pensioneve më 1 korrik	Gjithsej harmionizmi
2001	1,79%	-	1,79%
2002	0,63%	5,90%	6,56%
2003	2,97%	2,68%	5,72%
2004	0,80%	0,41%	1,21%
2005	-	0,40%	0,40%
2006	0,48%	2,18%	2,67%
2007	0,64%	1,04%	1,69%
2008*	13,00%	7,65%	21,66%
2009	3,50%	2,02%	5,59%
2010	0,30%	1,10%	1,40%
2011	0,75%	2,10%	2,86%
2012	0,31%	1,40%	1,71%
2013*	1,15%+5% nga shkurti	0,75%	7,00%


*Harmonizim i rregullt dhe plotësues

Në periudhën prej vitit 2001 deri në vitin 2013 pensionet më së shumti u rritën në vitin 2008, për shkak të harmonizimit plotësues të pensioneve me Vendim të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë dhe vitin 2013 me Ligjin për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për sigurim pensional dhe invalidor, që solli të rritet vlera reale e pensioneve dhe të përmirësohet siguria sociale dhe materiale e përfituesve të pensionit.

Me harmonizimet e kryera të pensioneve, pensioni mesatar në dhjetor të vitit 2013 arrinte 11.845,00 denarë, dhe e njëjta në krahasim me vitin 2012 në shumë prej 11.038,00 denarë është më e lartë për 7,3%. Rritja është rezultat i harmonizimit të rregullt dhe të kryer të pensioneve të kryera për vitin 2013, si dhe lartësinë e pensioneve të përfituesve të rinj të pensionit.

Tabela 10: Pensionet mesatare sipas llojit, në dhjetor të vitit 2012 dhe 2013 arrijnë edhe atë:

Lloji i pensioneve	2012	2013	Indeks
	në denarë		
Pension i pleqërisë	12.437	13.287	106,8
Pension invalidor	9.934	10.597	106,7
Pension familjar	8.634	9.270	107,4
Pension bujqësor	3.950	4.948	125,3
Pension ushtarak	18.096	19.175	106,0
GJITHSEJ	11.038	11.845	107,3



Krahasimi i pagesës të pensionit mesatar në dhjetor të vitit 2013 (pa panesione bujqësore dhe ushtarake) prej 11.819,00 denarë dhe paga mesatare e paguar në dhjetor të vitit 2013 në shumë prej 21.500,00 denarë në Vend arrin 55%, ndërsa krahasimi për pensionin e pleqërisë në shumë prej 13.287,00 denarë në raport me pagën mesatare arrin 61,8%.

Pensioni i paguar mesatar me pensionet ushtarake dhe minimale të bujqve në dhjetor të vitit 2013 arrin 11.845 denarë dhe në krahasim me pagën mesatare

arrin 55,09 edhe atë: 13.287,00 denarë pension pleqërie, 10.597,00 denarë pension invalidor dhe 9.270 denarë pension familjar.

Tabela 11: Pjesëmarrja e pensioneve në pagën mesatare neto:

Viti	Pension plrqërie	Pension invalidor	Pension familjar	Gjithsej pensione
2001	70,8	53,5	50,6	61,7
2002	69,1	52,5	49,1	60,2
2003	70,4	53,7	49,9	61,4
2004	67,8	51,9	48,1	59,3
2005	64,9	49,9	45,9	56,9
2006	63,3	48,7	44,4	55,5
2007	57,6	44,4	40,2	50,5
2008	62	49,3	44,6	55
2009	55,4	44,3	39,7	49,1
2010	54,1	42,9	38,3	47,9
2011	56,5	44,5	39,6	49,9
2012	57,9	46,3	40,2	51,3
2013	61,8	49,29	43,12	55,0

Pjesëmarrja e të gjitha llojeve të pensionit në krahasim me pagën mesatare neto të paguar në punëtor, në vitin 2013 në raport me vitin 2012, është e zmadhuar prej 51,3% në 55,0%.

Tabela 12: Struktura e përfituesve të pensionit sipas grupeve të shumave të pensioneve

Grupe të vlerave	Familjare	Struktura	Invalidore	Struktura	Pleqërisë	Struktura	Bujqësore	Struktura	Ushtarake	Struktura	Gjithsej	Struktura
në denarë		%		%		%		%		%		
deri 6.562,00	9.020	11,7	3.136	7,3	10.825	6,4	874	99,3	1	0,1	23.856	8,2
6.562,00 - 8.900,00	38.397	49,9	14.832	34,7	27.749	16,4	6	0,7	0	0,0	80.984	27,8
8.900,00 - 15.000,00	23.723	30,8	19.136	44,8	77.256	45,6	0	0,0	378	20,7	120.493	41,3
15.000,00 - 24.000,00	5.153	6,7	5.013	11,7	43.146	25,5	0	0,0	1215	66,5	54.527	18,7
24.000,00 - 34.462,00	614	0,8	559	1,3	8.948	5,3	0	0,0	211	11,5	10.332	3,5
mbi 34.462,00	104	0,1	65	0,2	1.438	0,8	0	0,0	22	1,2	1.629	0,6
Gjithsej	77.011	100,00	42.741	100,0	169.362	100,0	880	100,0	1827	100,0	291.821	100,0

Prej 289.114 përfitues të pensionit, 22.981 përfitues apo 7,9% pranojnë pension deri 6.562,00 denarë, që paraqet vlerën më të ulët të pensionit nga grupi i tretë i pensioneve me shumë më të ulët, 80.978 përfitues të pensionit pranojnë prej 6.562,01 deri 8.900 denarë, që paraqet shumën më të lartë nga grupi i parë të pensioneve të ulëta, përkatësisht 120.115 përfitues të pensionit apo 41,5% pranojnë pension në lartësi deri 15.000,00 denarë që paraqet shumën më të lartë nga grupi i tretë i pensioneve nga pensionet më të ulëta.

Tabela 13: Numri i përfituesve të pensionit të cilët pranojnë pension nën vlerën e garantuar të pensionit më të ulët prej 6.562,00 denarë, për shkak të pranimit të pjesës proporcionale nga shtetet tjera sipas grupit të vlerave.

Grupet e vlerave denarë	Përfitues	Struktura	Përfitues kumulativ	Struktura kumulative
deri 500,00	21,00	0,1	21	0,1
500,01-1.000,00	1.128,00	6,9	1.149	7,0
1.000,01-1.500,00	2.386,00	14,6	3.535	21,6
1.500,01-2.000,00	2.067,00	12,7	5.602	34,3
2.000,01-2.500,00	1.670,00	10,2	7.272	44,5
2.500,01-3.000,00	1.506,00	9,2	8.778	53,7
3.000,01-3.500,00	1.226,00	7,5	10.004	61,2
3.500,01-4.023,50	1.141,00	7,0	11.145	68,2
4.000,01-4.500,00	1.101,00	6,7	12.246	75,0
4.500,01-5.000,00	1.041,00	6,4	13.287	81,3
5.000,01-5.500,00	1.033,00	6,3	14.320	87,7
5.500,01-6.000,00	912,00	5,6	15.232	93,2
6.000,01<6.562,00	1.104,00	6,8	16.336	100,0
Gjithsej	16.336,00	100,0		

Tabela 14: Lartësia dhe numri i përfituesve me shumë më të ulët të pensionit nga grupi i tretë

]Viti	Vlera më e ulët e pensionit (denarë)	Shfrytëzues të vlerës më të ulët të pensionit nga grupi i tretë
2000	3.362,00	16.761
2001	3.422,00	19.436
2002	3.647,00	20.565
2003	3.856,00	20.809
2004	3.903,00	21.173
2005	3.918,00	21.577
2006	4.023,00	22.142
2007	4.091,50	22.102
2008	5.262,00	22.342
2009	5.556,00	22.575
2010	5.634,00	22.357
2011	5.795,50	23.841
2012	5.895,00	22.534
2013	6.562,00	16.336

Pjesëmarrja e përfituesve të vlerës më të ulët të pensionit në vitin 2013 (16.336) në raport të gjithsej numrit të përfituesve të pensionit (291.821) arrinte 5,6%, ndërsa në vitin 2012 arrin 7,9%, e cila tregon në faktin se është reduktuar pjesëmarrja e shfrytëzuesve të vlerës më të ulët të pensionit, e cila garantohet për përfituesit e pensionit të cilët pensionin e realizojnë me stazh më të ulët të pensional.

IV. PUNA FINANCIARE E FONDIT

Me Buxhetin e Fondit të sigurimit pensional dhe invalidor të Maqedonisë për vitin 2013 si dhe me ndryshimet dhe plotësimet e Buxhetit të Fondit, si pjesë përbërëse e Buxhetit të Vendit, ishte e planifikuar që puna financiare e Fondit të realizohet me të hyrat dhe të dalat e ribalancuara. Si bazë e realizimit të balancit ndërmjet të hyrave dhe dalave që ishin indikatorët makroekonomik për rritjen e të hyrave nga kontributet për 4,3% (3,3% nga rritja e papapararë e pagave dhe 1,0% rritja e punësimeve), si dhe sigurimin e mjeteve nga Buxheti i Vendit për obligimet e

rregullta ligjore, për shpenzimet transitive dhe mbulimin e deficitit të Fondit. Rritja e pagave të punëtorëve, si një faktor më i rëndësishëm nga i cili paguhet dhe llogaritet kontributi për sigurim pensional dhe invalidor dhe rritja e punësimeve, janë të ndikimit të rëndësishëm për realizimin e lartësisë të të hyrave në Fond. Në pjesën e të dalave ishte e projektuar pagesë e rregullt e pensioneve dhe rritje prej 5% nga dhjetori i vitit 2012, harmonizim ligjor prej 1 korrikut të vitit 2013 prej 1,12% dhe 1,77% nga 1 korriku i vitit 2013 dhe rritja e numrit të përfituesve të pensionit prej 1% në nivel vjetor.

Në punën financiare të Fondit ndikon edhe ndryshimi i shkallës së kontributit për sigurim pensional dhe invalidore, si dhe masat e ndërmarra të Fondit për pagesën e kontributeve të prapambetura përfundimisht me vitin 2008.

Shkalla e kontributit për sigurim pensional dhe invalidor në vitin 2013 arrin 18%, në mbështetje të Ligjit për kontribute nga sigurimi i detyrueshëm social dhe e njëjta kishte ndikim ndaj realizimin e të hyrave nga kontributet e Fondit.

Fondi edhe në vitin 2013 ndërrmer masa për pagesë maksimale të kontributeve të prapambetura për periudhën deri 31.12.2008, për të cilin ishte i përpunuar Plan aksionar për përcaktim të plotë të kontributit të papaguar, bllokim të llogarisë të obliguesve të cilët nuk e kanë paguar kontributin, si dhe pagesë e mundësuar në më shumë këste për kontributet e prapambetura dhe të papaguara. Deri te obliguesit të cilët nuk e kanë paguar kontributin e prapambetur u janë dorëzuar procesverbale, aktvendime për marrjen e borxhit dhe aktvendime për bllokimin e llogarisë. Si rezultat i aktiviteteve të ndërmarra të Fondit dhe Qeverisë të Republikës së Maqedonisë në vitin 2013 u soll Ligj për shlyerjen e kamatave të obligimeve të borxhit të papaguar në bazë të kontributeve për sigurim social. Në mbështetje të këtij ligji obliguesit mundeshin që të paguajnë kontributin e prapambetur për SPI deri 31.12.2008 përfundimisht me 30.11.2013 nga gjithsej kërkesat e parashtruara nga ana e të obliguarve për kontribut të papaguar në mbështetje të ligjit për shlyerjen e kamatave sipas obligimeve të borxhit të

papaguar për kontribute nga sigurimi social ishin të paguara 273,33 milion denarë, ndërsa ishin të shlyera 255,52 milion denarë në emër të interesit në bazë të pagesës jo në kohë të kontributit për SPI me çka obliguesit fituan kushte të volitshme dhe ishin të liruar nga interesi.

Nga masat e ndërmarra në pjesën e pagesës të kontributeve të papaguara dhe të prapambetura për periudhën deri 31.12.2008, janë paguar mjete në shumë prej mbi 468,88 milion denarë.

Gjithashtu me konkluzion të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, ndërsa në mbështetje për shndërrimin e kërkesave të Republikës së Maqedonisë në bazë të të dalave publike të investimit të përhershëm në fabrikën për automjete hekurudhore “Veles” SHPKNJP – Veles në dhjetor të vitit 2013 janë paguar mjete në shumë prej 8,34 milion denarë në emër të kontributit për SPI dhe 7,4 milion denarë për interes në bazë të pagesës së kontributit nga paga jo në kohë.

Me mjetet që u realizuan nga kontributet si dhe me mjetet e dedikuara nga Buxheti i Vendit, nga shitja e aksioneve dhe pjesëve me të cilat disponon Fondi, nga të hyrat e akcizave të hyrat tjera jo tatimore Fondi në vitin 2013 realizoi të hyra totale në shumë prej 51.070,23 milion denarë. Me këto mjete dhe me mjetet e transferuara nga viti 2012 (542,09 milion denarë), Fondi zbatoi gjithsej të dala në shumë prej 50.845,76 milion denarë.

Fondi në vitin 2013 rregullisht e kryente pagesën e pensioneve në afatet e parapara, në javën e parë nga muaji për muajin paraprak, me përdorimin e huasë nga Buxheti i Vendit, të cilën e kthente pas pagesës të pensioneve dhe akumulimit të mjeteve nga kontributet.

Gjithsej të hyrat e Fondit në raport me mjetet e planifikuara me Buxhetin e Fondit për vitin 2013, janë më të larta për 1%, ndërsa në krahasim me vitin 2012 janë më të larta për 10,2%, për shkak mjeteve të rritura të transferimit për mbulimin e deficitit rrjedhës, përderisa të dalat totale janë në nivel të mjeteve të planifikuara me Buxhetin, ndërsa në krahasim me vitin 2012 të njëjtat janë më të larta për 10%.

1. Të hyrat e Fondit

Gjithsej të hyrat e Fondit në shumë prej 51.070,23 milion denarë janë realizuar nga burimet e më poshtme të financimit:

- **nga të hyra burimore** (kontribut nga paga, stazh i beneficuar, kontribut nga personat që kryejnë veprimtari dhe të punësuar tek ata si dhe nga bujqit individual dhe Agjencia e punësimit) janë realizuar mjete në shumë prej 28.706,74 milion denarë apo 56,2% nga gjithsej të hyrat,

- **mjete nga Buxheti i Vendit** janë realizuar në shumë prej 21.060,83 milion denarë apo 41,2% nga gjithsej të hyrat,

- **nga akcizat** janë realizuar mjete në shumë prej 870,16 milion denarë apo 1,7% nga gjithsej të hyrat,

- **nga dividenda** janë realizuar mjete në shumë prej 2,25 milion denarë **dhe nga shitja e aksioneve dhe pjesëve** janë realizuar mjete në shumë prej 287,56 milion denarë apo gjithsej 289,81 milion denarë të cilat në raport të gjithsej të hyrave të cilët arrijnë 0,6%,

- **nga të hyrat e tjera** janë realizuar mjete në shumë prej 142,69 milion denarë apo 0,3% nga gjithsej të hyrat.

Kontributi nga paga llogaritet në shkallë prej 18% të bruto pagës dhe është burim kryesor për financimin e Fondit. Kontributet e paguara Fondi i shpërndan ndërmjet Shtyllës së Parë dhe Dytë pensionale. Shpërndarja e kontributit në vitin 2013 ndërmjet Shtyllës së parë dhe dytë me hyrjen e Ligjit të ri në fuqi për sigurim pensional dhe invalidor, prej 08.08.2012, përcaktoi shkallë fikse të kontributit për shtyllën e parë prej 12% ndërsa për Shtyllën e dytë prej 6%.

Në vitin 2013 nga kontributet e pagës, janë realizuar mjete në shumë prej 27.557,10 milion denarë dhe të njëjtat në raport me të planifikuarat e Buxhetit të Fondit shënojnë rritje prej 0,6% apo 355,47 milion denarë, ndërsa në krahasim me vitin 2012 janë më të larta për 3,6% apo 969,13 milion denarë. Pjesëmarrja e kontributit të pagës nga të hyrat totale arrin 54,0%. Në rritjen e kontributit nga

paga në vitin 2013 kishte ndikim edhe pagesa e kontributeve të papaguara, përfundimisht me 31.12.2008, në shumë mbi 461,88 milion denarë si rezultat i Ligjit të sjellë për shlyerjen e kamatave të obligimeve të borxhit të papaguar në bazë të kontributeve nga sigurimi social (Gazeta Zyrtare e RM-së 26/2013) me të cilin në bazë të kërkesave të parashtruara nga ana e të obliguarve janë paguar 273,33 milion denarë nga gjithsej të paguarat 461,88 dhe 182,55 milion denarë nga aktivitetet e zmadhuara të Fondit për pagesën e të njëjtëve.

Në dhjetor të vitit 2013 nga Buxheti i Vnedit, ndërsa në mbështetje të Ligjit për shndërrimin e kërkesave në Republikën e Maqedonisë në bazë të të dalave publike në investime të përhershme për Shoqërinë fabrikë për automjete hekurudhore “Veles” Veles, si dhe në mbështetje të konkluzioneve të sjella në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë, janë paguar në emër të kontributit për sigurim pensional dhe invalidor, mjete në shumë prej 8,34 milion denarë dhe kamatë në shumë prej 7,40 milion denarë kamatë për pagesë jo në kohë të kontributeve për pagë kështu që e hyra e kontributit nga paga është e zmadhuar sipas asaj baze.

Kontributi nga paga sipas muajve në vitin 2013 dhe 2012 lëviz sipas dinamikës së mëposhtme:

Tabela 15: Kontribut nga paga sipas muajve

Muajt	Kontribute të paguara		Indeksi	Dallimi
	2013	2012		
Janar	1.829,27	1.758,94	104,0	70,33
Shkurt	2.231,00	2.188,83	101,9	42,17
Mars	2.227,55	2.198,23	101,3	29,32
Prill	2.532,99	2.250,13	112,6	282,86
Maj	2.075,96	2.240,46	92,7	-164,50

Qershor	2.146,03	2.118,16	101,3	27,87
Korrik	2.451,45	2.259,96	108,5	191,49
Gusht	2.220,80	2.185,64	101,6	35,16
Shtator	2.245,12	2.231,33	100,6	13,79
Tetor	2.327,86	2.241,60	103,8	86,26
Nëntor	2.520,41	2.315,09	108,9	205,32
Dhjetor	2.748,66	2.599,60	105,7	149,06
Gjithsej	27.557,10	26.587,97	103,6	969,13

Nga tabela shihet se kontributi nga paga në vitin 2013 në raport të vitit 2012 është më i lartë për 3,56%, ndërsa sipas muajve ka një realizim më të madh në muajin prill, korrik dhe nëntor të vitit 2013.

Të hyrat nga kontributi i përfitimit (341,60 milion denarë), **të hyrat nga personat fizik që kryejnë veprimtari dhe të punësuarit tek ato** (672,82 milion denarë) si dhe nga **bujqit individual** (84,46 milion denarë) janë realizuar në shumë prej 1.098,88 milion denarë dhe pjesëmarrja e tyre në gjithsej të hyrat arrin 2,2%.

Të hyrat nga Agjencia e punësimit dedikohen në bazë të kontributit për personat e pa punë të cilët pranojnë kompensim në të holla. Në vitin 2013 në këtë bazë janë dedikuar mjete në shumë prej 50,76 milion denarë dhe të njëjtat në krahasim me vitin 2012 (84,25 milion denarë) janë më të ulëta për 33,49 milion denarë apo për 39,8%, ndërsa pjesëmarrja e tyre në gjithsej të hyrat e Fondit arrin vetëm 0,1%. Këto mjete nga viti në vit reduktohen për shkak zvogëlimit të numrit të personave për të cilët paguhet kontribut për shkak ndryshimit të dispozitave ligjore të paguhet kontribut vetëm për personat të cilët nuk kanë 15 vjet përvojë pune.

Të hyrat nga akcizat janë realizuar në shumë prej 870,16 milion denarë dhe të njëjtat në gjithsej të hyrat marrin pjesë me 1,7%. Këto të hyra llogariten sipas shkallës prej 9,18% nga derivatet e naftës. Në krahasim me vitin 2012 të hyrat nga akcizat janë më të larta për 2,2%, ndërsa në krahasim me të planifikuarat janë zmadhuar për 1,2%.

Mjetet transferuese nga Buxheti i Vendit janë realizuar në shumë prej 21.060,83 milion denarë dhe të njëjtat janë në kuadër të mjeteve të planifikuara me Buxhetin e Fondit (99,8%), ndërsa në krahasim me të hyrat e realizuara në vitin 2012 (17.503,34 milion denarë) janë më të larta për 20,5%. Mjetet e dedikuara i dedikohen edhe atë:

- 3.413,33 milion denarë për obligime ligjore (për shfrytëzues të pensioneve minimale bujqësore, pensione ushtarake, luftëtarë para dhe pas 09.09.1943, shfrytëzues në barrë të Vendit, mësues, shfrytëzues në SHNP (shtëpia ndëshkimore përmirësuese) si dhe për pagesën e dallimeve në bazë të harmonizimit prej 8% për periudhë të kaluar në mbështetje me aktgjykimin e Gjykatës supreme të RM-së).

- 4.200,00 milion denarë për shpenzimet transitive,

- 13.350,93 milion denarë për mbulimin e deficitit rrjedhës,

- 93,57 milion denarë transfer nga Ministria e mbrojtjes dhe

- 3,00 milion denarë për mbulimin e shpenzimeve të rrugës për banjat.

Pjesëmarrja e të hyrave nga Buxheti i Vendit në gjithsej të hyrat e Fondit arrin 41,2%, ndërsa pjesëmarrja e deficitit rrjedhës në gjithsej transferin arrin 63,4% dhe i njëjti shënon rritje nga viti në vit. Mjetet nga Buxheti i Vendit është i dyti sipas madhësisë të të hyrave dhe përfaqëson shkallë të rëndësishme në financimin e sigurimit pensional dhe invalidor. Të hyrat nga Buxheti i Vendit rregullisht janë dedikuar, me llogaritjet e dorëzuara paraprake mujore nga ana e Fondit.

Të hyrat nga dividenda dhe nga shitja e aksioneve dhe pjesëve në vitin 2013 janë realizuar në shumë prej 289,81 milion denarë edhe atë:


- **Nga dividenda** janë realizuar mjete në shumë prej 2,25 milion denarë.

- **Nga shitja e aksioneve dhe pjesëve** janë realizuar mjete në shumë prej 287,56 milion denarë dhe të njëjtat janë më të larta dhe me mjetet e planifikuara me Buxhetin e Fondit për 6,5% dhe në krahasim me mjetet e realizuara në vitin 2012 për 241,4%.

- **Nga të hyrat e tjera** janë realizuar mjete në shumë prej 142,69 milion

Denarë dhe të njëjtat janë më të ulëta për 5% në krahasim em të planifikuarat, ndërsa në raport me vitin 2012 për 4,7% në pjesën më të madhe për shkak të shumë së ulët të të hyrave në bazë të kërkesave të dëmshme nga ish republikat Jugosllave.

Struktura e të hyrave në vijim:



Sipas strukturës të të hyrave, pjesëmarrje më të madhe nga të hyrat totale është nga kontributi i pagës me 54,0%, nga Buxheti i Vendit me pjesëmarrje prej 41,2%, apo sipas të dy bazave pjesëmarrja e të hyrave arrin 95,2%, përderisa nga të gjitha të hyrat tjera mjetet e realizuara marrin pjesë me 4,8% në gjithsej të hyrat.

Tabela 16: Të hyrat e realizuara dhe të planifikuara të Fondit në vitin 2013:

Nr. rendor	Lloji i të hyrave	Buxheti për vitin 2013	Të realizuara I-XII 2012	Të realizuara-XII 2013	Indeksi 4:2	Indeksi 4:3
0	1	2	3	4	5	6
1	Kontribut nga paga	27.392,57	26.587,97	27.557,10	100,6	103,6
2	Kontribut nga të hyrat	341	346,21	341,6	100,2	98,7
3	Sektori privat	691	651,03	672,82	97,4	103,3
4	Bujq individual	80	74,59	84,46	105,6	113,2
5	Të hyra nga Agjencia e punësimit	57	84,25	50,76	89,1	60,2
	Gjithsej kontribute	28.561,57,00	27744,05	28706,74	100,5	103,5
6	Të hyra nga akcizat	875	851,03	870,16	99,4	102,2
7	Transfer nga Buxheti i Vendit	21.092,00	17.503,34	21.060,83	99,90	120,30
8	Të hyra tjera	150	149,65	142,69	95,1	95,3
9	Të hyra nga dividendi	5	3	2	45	65
10	Të hyra nga shitja e letrës me vlerë	270	119,12	287,56	106,5	241,4
	Gjithsej të hyra	50.953,57	46.370,63	51.070,23	100	110

2. Të dalat e Fondit

Me Buxhetin e Fondit për vitin 2013 në pjesën e të dalave në mbështetje të indikatorëve makroekonomik ishte i projektuar pagesë e rregullt e pensioneve dhe rritjen e të njëjtëve prej 5% nga dhjetori i vitit 2012, harmonizimi ligjor prej 1 janarit të vitit 2013 prej 1,12% dhe 1,77% prej 1 korrikut të vitit 2013 si dhe rritja e numrit të shfrytëzuesve të pensionit prej 1% në nivel vjetor.

Të dalat totale të Fondit në vitin 2013 arrin 50.854,76 milion denarë dhe të njëjtat janë në nivel të të planifikuarave me Buxhetin e Fondit, ndërsa më të larta janë për 10,0% në raport me të dalat e kryera në vitin 2012.

Të dalat e Fondit kanë të bëjnë edhe atë:

- **Të dalat për pagesën e pensioneve** të cilët arrijnë 40.812,95 milion denarë (40.328,26 milion denarë për pensione të rregullta, 426,09 milion denarë për pensione ushtarake dhe 58,60 milion denarë për pensione të bujqëve) apo 80,3% nga gjithsej të dalat.

- **Kontributi për sigurim shëndetësor** për përfituesit e pensionit arrin 5.359,18 milion denarë dhe i njëjti në gjithsej të dalat merr pjesë me 10,5%. Të dalat për pensione të paguara së bashku me kontributin për sigurim shëndetësor arrijnë 46.172,13 milion denarë dhe të njëjtat në gjithsej të dalat marrin pjesë me 90,8%.

- **Të dalat për pagesën e kompensimeve nga sigurimi invalidor, vendosjen e fëmijëve invalid në konvikt dhe dëmtimi fizik** arrijnë 100,57 milion denarë apo 0,2% nga gjithsej të dalat. Kompensimet nga sigurimi invalidor arrijnë 7,08 milion denarë dhe të njëjtat në krahasim me të dalat e vitit 2012 janë reduktuar për 2,2% si rezultat i ndryshimeve të dispozitave ligjore sipas të cilave këto kompensime janë transformuar në pension invalidor, ndërsa ka 1 përfitues të ri me të drejtë të rehabilitimit profesional. Kompensimi për dëmtim fizik arrin 92,16 milion denarë, ndërsa për vendosje në konvikt 1,33 milion denarë.

- **Transferimi i mjeteve për fondet pensionale private** në vitin 2013 arrin 4.141,29 milion denarë dhe të njëjtat në gjithsej të dalat marrin pjesë me 8,14%. Këto të dala janë në nivel të mjeteve të planifikuara me Buxhetin e Fondit (98,6%), ndërsa 15,1% janë më të larta në krahasim me vitin 2012 për shkak të rritjes të anëtarëve në fondet pensionale private. Numri i të siguruarve, anëtarë në fondet pensionale private në fund të vitit 2012 arrinte 324.480 (me gjendje më 31.12.2012) dhe i njëjti më 31.12.2013 arrin 350.040 anëtarë apo më shumë për 26.560 anëtarë, për shkak të anëtarësimit të detyrueshëm të të gjithë të punësuarve të rinj në fondet pensionale private. Këto mjete kompensohen nga Buxheti i Vendit.

- **Pagat e të punësuarve të Shërbimit profesional** të Fondit në vitin 2013 arrijnë 247,34 milion denarë apo 0,5% në raport të gjithsej të dalave. Të dalat e zbatuara për të punësuarit në Shërbimin profesional janë në nivel të mjeteve të planifikuara (98,9%), ndërsa në krahasim me vitin 2012 janë më të ulëta për 4,0% për shkak pensionimit të të punësuarve, ndërsa një pjesë e tyre e kanë lëshuar Fondin dhe vendet e zbrazëta nuk janë plotësuar, në mbështetje me konkluzionin e masave antikrime të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë nuk lejohet plotësim i vendeve

të zbrazëta të punës për punëtorët e pensionuar nga Fondi. Numri i të punësuarve me gjendje në dhjetor të vitit 2013 arrin 654 të punësuar.

- **Të dalat e tjera** në vitin 2013 janë zbatuar në shumë prej 176,67 milion denarë apo 0,3% në raport të gjithsej të dalave. Këto shpenzime në raport të të planifikuarave janë zbatuar me 98,4%, ndërsa në krahasim me të zbatuarat nga viti 2014 të njëjtat janë më të larta për 9,5%, ndërsa për shkak të mjetevetë kryera për qëllime tjera për pagesën e obligimeve për shërbime komunale të bartura për pagesë nga viti 2012.

- **Shpenzimet kapitale** janë zbatuar në shumë prej 6,01 milion denarë të cilat në krahasim me mjetet e planifikuara për këtë qëllim në shumë prej 6,03 milion denarë përfaqësojnë kryerje prej 100%. Në vitin 2013 këta mjete janë shpenzuar për blerjen e pajisjes informatike dhe zyreve.

- **Shpenzimet për rikonstruimin e objekteve afariste** janë zbatuar në shumë prej 9,28 milion denarë, edhe atë për rikonstruimin e objekteve në Shkup dhe Dellçevë, në shtëpitë për jetesë të shfrytëzuesve të pensionit në Kriva Pallankë, Çair dhe Gjorçe Petrov.

- **Blerje e automobilit** - është furnizuar një automobil për nevojat e Fondit pas pëlqimit të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë në shumë prej 1,47 milion denarë.

Struktura e të dalave paraqitet në poshtë:




Tabela 17: Të dalat totale të Fondit të paraqitur në tabelën më poshtë:

Nr. rendor	Lloji i të dalave	Buxheti për vitin 2013	Të realizuara I-XII 2012	Të realizuara I-XII 2013	Indeks 4:2	Indeks 4:3
0	1	2	3	4	5	6
1	Gjithsej pensione	40.830,07	37.292,59	40.812,95	100	109,4
2	Pagesë në bazë të sig. det.kapi.	4.200,00	3.599,49	4.141,29	98,6	115,1
3	Kompensime nga sigurimi invalidor	111,00	100,65	100,57	90,6	99,9
4	Kontribut për sigurim shëndetësor	5.366,00	4.798,82	5.359,18	99,9	111,7
5	Paga dhe kompensime	250,00	257,28	247,34	98,9	96,1
6	Të dala tjera, shpenzime kapitali dhe rikonstruim të objekteve afariste	196,50	177,93	193,43	98,4	108,7
	Gjithsej të dala	50.953,57	46.226,76	50.854,76	99,8	110

Tabela 18: Lëvizja e të hyrave sipas viteve në milion denarë

Viti	Të hyra burimore	Agjencioni për punësim	Buxheti	Akciza	Të hyra tjera	Dividendi	Shitja e aksioneve	Gjithsej
1994	13.598,92	35,78	2.944,61	835,15	79,82			17.494,28
1995	14.012,00	274,81	2.830,00	857,5	36,56			18.010,87
1996	13.644,78	535,43	3.289,00	778,87	31,46	47,18		18.326,72
1997	13.735,57	816,26	3.516,00	731,02	32,02	48,38		18.879,25
1998	14.500,28	967,72	3.618,57	693,86	120,87	49,94	569,48	20.520,72
1999	15.979,18	863,91	3.266,07	633,24	43,05	68,68	177,52	21.031,65
2000	16.662,36	1.100,07	4.174,42	802,07	88,22	53,86	15,55	22.896,55
2001	16.419,97	1.126,48	5.744,48	716,09	75,58	39,44	167,54	24.289,58
2002	16.535,92	1.403,34	6.960,91	687,83	29,2	19,68	172,51	25.809,39
2003	17.651,84	1.536,13	7.740,95	677,04	80,13	20,98	20,63	27.727,70
2004	18.034,17	1.718,70	8.486,44	660,97	56,09	20,6	50,91	29.027,88
2005	18.339,08	1.549,89	8.255,08	659,14	62,74	18,13	27,65	28.911,71
2006	19.948,52	1.219,77	9.370,85	661	223,75	22,75	962,6	32.409,24
2007	21.914,23	864,98	10.378,52	681,04	151,89	5,88	56,71	34.053,25
2008	25.581,91	773,58	10.181,99	717,4	247,71	21,48	97,63	37.621,70
2009	26.279,53	256,49	14.020,85	744,49	194,11	19,41	74,64	41.589,52
2010	26.137,49	163,9	14.218,12	787,57	112,17	10	40,78	41.470,03
2011	26.890,36	122,19	15.704,97	813,77	122,23	7,22	276,35	43.937,09
2012	27.659,80	84,25	17.503,34	851,03	149,65	3,44	119,12	46.370,63
2013	28.655,98	50,76	21.060,83	870,16	142,69	2,25	287,56	51.070,23

Gjithsej të hyrat në vitin 2013 në raport të vitit 1994 janë rritur për 291,93%, ndërsa mjetet nga Buxheti i Vendit për 715,23%. Të hyrat nga Agjencia e punësimit në mënyrë drastike janë reduktuar nga viti 2009 për shkak ndryshimeve të dispozitave ligjore, në raport të fitimit të së drejtës si dhe në raport të bazave dhe përqindjes së llogaritjeve për realizim.

Në grafikonin më poshtë është paraqitur lëvizja e të hyrave sipas viteve:





Tabela 19: Lëvizja e të dalave sipas viteve

Viti	Pensione	Kontribute nga sigurimi invalidor	Kontribut shëndetësor	Shërbimi profesional	Të dala tjera kapitale	Shpenzime tranzitive	Gjithsej
1994	15.404,40	391,66	2.102,03	118,77	427,72		18.444,58
1995	15.684,34	204,11	2.082,07	127,20	198,97		18.295,69
1996	16.223,17	185,26	2.217,54	128,43	170,61		18.925,01
1997	16.694,20	179,22	2.292,43	128,33	209,89		19.504,07
1998	17.730,56	177,48	2.320,67	130,17	174,52		20.533,40
1999	17.757,99	177,80	2.450,13	132,14	163,53		20.681,29
2000	19.745,20	173,44	2.674,37	142,03	206,53		22.941,57
2001	21.282,34	170,19	2.800,73	153,37	290,23		24.696,86
2002	22.252,52	179,85	2.927,64	164,82	352,59		25.880,42
2003	24.028,33	182,89	3.183,98	171,41	197,74		27.764,35
2004	25.108,05	189,07	3.349,18	168,89	301,62		29.116,81
2005	24.970,08	199,61	3.416,82	171,73	272,67		29.028,91
2006	25.410,57	224,98	3.582,45	177,17	486,40	1.325,14	31.206,70
2007	26.305,27	247,79	3.714,03	240,33	385,13	1.877,00	32.769,55
2008	30.953,74	115,58	4.367,89	256,16	549,24	2.490,53	38.733,14
2009	33.537,64	107,53	4.290,57	264,64	260,39	2.932,20	41.392,97
2010	34.437,32	103,52	4.338,25	251,55	203,89	3.172,93	42.507,46
2011	35.751,31	101,65	4.524,32	273,81	172,07	3.482,61	44.305,77
2012	37.292,59	100,65	4.798,82	257,28	177,93	3.599,49	46.226,76
2013	40.812,95	100,57	5.359,18	247,34	193,43	4.141,29	50.854,76

Në periudhën prej vitit 1994 deri në vitin 2013, gjithashtu janë rritur edhe të dalat si rezultat i rritjes së numrit të përfituesve të pensionit dhe harmonizimit të pensioneve.

Të dalat për pagesën e pensioneve në vitin 2013 arrijnë 40.812,95 milion denarë dhe në krahasim me vitin 1994 janë rritur për 264,9%, të dalat për pagat e të punësuarve janë rritur për 208,2%, ndërsa rritjet tjera shënojnë reduktim, përderisa gjithsej të dalat në krahasim me vitin 1994 janë rritur për 275,7%. Nga viti 2006 në mbështetje me Ligjin për sigurimin e detyrueshëm pensional me financim kapital, në Fond filluan të realizohen të dala në bazë të transferimit të mjeteve në fondet pensionale private për kontributin e sigurimit pensional dhe invalidor për anëtarët të cilët janë kyçur në fondet pensionale private. Këto të dala janë rritur nga 1.325,14 milion denarë në vitin 2006, në 4.141,29 milion denarë në vitin 2013 apo për 312,5%, për shkak numrit të rritur të anëtarëve.

Në grafikonin e mëposhtëm është paraqitur lëvizja e të dalave sipas viteve:



3. Rezultate financiare

Në vitin 2013, Fondi realizoi gjithsej të hyra në shumë prej 51.070,23 milion denarë, ndërsa gjithsej të dalat arrinin 50.854,76 milion denarë. Gjithsej të dalat në krahasim me vitin 2012 janë më të larta për 10,1%, ndërsa të dalat për 10% dhe në krahasim me mjetet e planifikuara edhe të hyrat dhe të dalat janë në nivel me të planifikuarat me Buxhetin e Fondit për vitin 2013.

Në vitin 2013 Fondi realizoi tepriçë të të hyrave mbi të dalat në shumë prej 215,47 milion denarë.

Me të hyrat e realizuara nga kontributet dhe mjetet nga Buxheti i Vendit, si dhe nga të hyrat tjera Fondi në vitin 2013 rregullisht e kryente pagesën e pensioneve në periudhën e caktuar – javën e parë të muajit për muajin paraprak, me shfrytëzimin e huasë nga Buxheti i Vendit, të cilën rregullisht e kthente pas pagesës së pensioneve dhe akumulimit të mjeteve nga të hyrat e realizuara.

4. Aksione dhe pjesë

Fondi i sigurimit pensional dhe invalidor i Maqedonisë në mbështetje me nenin 19 nga Ligji për transformimin e ndërmarrjeve me kapital shoqëror dhe neni 7 nga Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për transformimin e ndërmarrjeve me kapital shoqëror zotëron aksione dhe pjesë në nërmarrjet të cilët transformohen.

Në bazë të Ligji për transformimin e ndërmarrjeve me kapital shoqëror, Ligjit për sigurim pensional dhe invalidor, Rregulloren e procedurës për shitjen e aksioneve dhe pjesëve nga gjithsej kapitali i arritur në bazë të transformimit të ndërmarrjeve me kapital shoqëror (“Gazeta Zyrtare e RM-së” nr.105/2010 dhe 12/2012) dhe Kriteret për shitjen e aksioneve dhe pjesëve, të arritur në bazë të Ligjit për transformimin e ndërmarrjeve me kapital shoqëror, Këshilli drejtues i Fondit të sigurimit pensional dhe invalidor i Maqedonisë me propozim të Komisionit për aksione dhe pjesë merr vendime për shitjen e aksioneve dhe pjesëve.

Gjatë vitit 2013, u sollën tre vendime për shitje edhe atë: një vendim për shitjen e aksioneve të një shoqërie në mënyrë të pranimit të ofertës për blerjen e aksioneve, e cila u soll në mars dhe dy vendime për shitjen e pjesëve të Fondit, prej të cilave njëra ishte sjellë në mars, ndërsa tjetra në maj.

Në Bursën e Maqedonisë në vitin 2013 janë zbatuar 8 ankande publike të bursës në të cilët ishin të shitura aksione dhe pjesë prej 66 shoqërive. Nga shitja e aksioneve në bazë të pranimit të ofertës për blerjen e aksioneve dhe nga shitja e aksioneve dhe pjesëve të ankandëve bursore u realizuan mjete në shumë totale prej 287,56 milion denarë. Më pas për 17,56 milion denarë apo për 6,45% u tejkaluan mjetet e parapara me Buxhetin e Fondit për vitin 2013 të cilët u përcaktuan në shumë prej 270.000.000 denarë.

Gjatë vitit 2013, në mbështetje të nenit 193 paragrafi 7 nga Ligji për sigurim pensional dhe invalidor Fondi për shitjet e kryera të aksioneve dhe pjesëve nga kapitali i përgjithshëm i fituar në bazë të transformimit të ndërmarrjeve me kapital shoqëror, deri te Këshilli drejtues dhe deri te Qeveria e Republikës së Maqedonisë rregullisht dorëzonte informacione.

5. Pagesa e kontributeve të prapambetura

Me ndryshimin e regullativës ligjore nga viti 2009 dhe transferimin e kompetencave për pagesën e kontributit për sigurim pensional dhe invalidor dhe kontrollit të kontributeve të pa paguara në Drejtorinë e të Hyrave Publike, në Fondin e sigurimit pensional dhe invalidor mbeti kompetenca për pagesën e borxheve përfundimisht me 31.12.2008 si dhe mundësia për kontrole plotësuese të vërtetimit të të dhënave për kontributet, sipas nevojave të vërtetuara personale.

Shërbimi profesional i Fondit në bazë të gjendjeve të kontributeve të pa paguara të obliguesve udhëheq procedurë për pagesën e kontributeve të pa paguara vetëm të obliguesve aktiv në mbështetje me regullativën ligjore, përderisa për obliguesit pasiv (të likuiduar) nuk udhëheq procedurë, sepse nga të njëjtit nuk mund

ta paguajë kontributin, për obliguesit mbi të cilët janë hapur procedura falimentuese për kontributin e pa paguar përfundimisht me 31.12.2008, Fondi dorëzon fletëparaqitjen e kërkesës në procedurë falimentuese.

Shërbimi profesional i Fondit në vitin 2013 kishte aktivitete të shumta për pagesën e kontributeve të pa paguara nga obliguesit të cilët janë aktiv dhe kanë borxhe deri më 31.12.2005 dhe prej 01.01.2006 deri më 31.12.2008. Janë kryer kontrole të sërishme që të vërtetohet shuma e saktë e papaguar e kontributit, në mbështetje të të dhënave të marra nga evidentimi amë për periudhën për të cilët nuk është i përcaktuar stazhi i sigurimit dhe veçanërisht për stazhin deri më 31.12.2005.

Me kontrollet e kryera, saktë u përcaktua gjithsej shuma e kërkesave për kontributin e papaguar dhe gjithsej numrin e subjekteve – tatimpaguesve për pagesën e të njëjtit, i cili përfundimisht me 31.12.2012 arrinte 10.585.089,00 denarë.

Gjatë vitit 2013, Fondi udhëhiqte procedurë për pagesën e kontributeve të prapambetura deri në vitin 2008 edhe atë si në mënyrë të rregullt ashtu edhe të detyruar, është paguar kontribut dhe interes për pagesë të vonuar të kontributit, mjete në shumë prej rreth 461,880 milion denarë i cili është për 218,88 milion denarë më shumë në raport të vitit 2012 kur është i paguar kontributi prej 243,00 milion denarë.

Nga këta mjete, 273,33 milion denarë i dedikohen pagesës së plotë të borxhit në bazë të kontributit të prapambetur prej 830 subjekte në bazë të Ligjit të sjellë për shlyerjen e kamatave të obligimeve të papaguara në bazë të kontributit për sigurim social, përderisa pjesa tjetër prej 188,55 milion denarë është nga aktivitetet e rritura të Fondit për pagesën e të njëjtëve deri më 31.12.2012.

Nga analizat e zbatuara është konstatuar se borxhi i obliguesve lëviz prej 500.000 deri mbi një milion denarë. Numri më i madh i obliguesve janë me borxh deri 100.000 denarë, ndërsa numër më i vogël është numri me borxh të pa paguar prej mbi 1.000.000 denarë.

Në vitin 2013 me iniciativë të Fondit janë parashtruar ndryshime në Ligjin për falimentim dhe rregulloren për avancimin e shpenzimeve të procedurave të falimentimit me të cilët janë zvogëluar shpenzimet për avancimin e procedurës së falimentimit pas parashtrimit të propozimit për falimentim.

Me iniciativë të Fondit është kryer edhe ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit për shoqëritë tregtare me të cilat prolongohet afati i parashtrimit të propozimit për hapjen e procedurës së falimentimit për obliguesit të cilët Regjistri qendror i shpall në ueb faqen e tij prej një muaji në 12 muaj. Sipas asaj baze Fondi parashtroi 918 propozime për hapjen e procedurës të falimentimit për subjekte të cilët i shpalli Regjistri qendror i Republikës së Maqedonisë me kërkesë të kontributeve të prapambetura në shumë totale prej 343.041.075,00 denarë.

Shërbimi profesional i Fondit, gjithashtu, në vitin 2013 punonte edhe në pagat jo të alocuara të kontributeve, të cilat po qe se nuk janë të rradhitura siç duhet sipas subjekteve dhe të siguruarve, Fondi nuk mundet që ti shfrytëzon.

Ministria e punës sociale dhe politike në bashkëpunim me Drejtorinë e të Hyrave Publike, Fondin e SPIM-së dhe Agjencinë e punësimit të Republikës së Maqedonisë i zgjedhën një pjesë të problemeve rreth mjeteve të pashpërndara nga kontributet e paguara, ndërsa i referohen mungesës së fletëparaqitjeve M11/1, M11/2, M1, M2 dhe numrat amë të ndryshuar. Me këta aktivitete, një pjesë e mjeteve të paalocuara janë shpërndarë.

6. Informimi

Në Fondin e SPIM-së informimi i publikut në vitin 2013 kishte për qëllim që të plotësohen kërkesat e punësuarve nga njëra anë, ashtu edhe kërkesat e obliguesve, të siguruarve dhe shfrytëzuesve të pensionit për zgjidhjen e nevojave të tyre nga ana tjetër. Më pas, edhe në dy rastet ishte dhe mbetet shpërndarja bazë – informimi, përkatësisht përgjigjet e pyetjeve nëpërmjet udhëzimeve profesionale për zgjidhjen e problemeve të hapura.

Në Fondin e SPIM-së, informimi zhvillohet nëpërmjet gazetës për të punësuarit “Informator“ dhe nëpërmjet Ueb faqes e kyqur për të gjithë shfrytëzuesit e internetit. Pranë këtyre formave në bashkëpunim të ndërsjellë, në Fond me sukses funksionon edhe “Pensioner plus”, “Sistemi një spoertelësh”, “Semafori” për vlerësimin e cilësisë të shërbimeve nga punëtorët në sportele, “Nuk ka derë të gabuar” dhe shërbim informativ (Grup për komunikim, shërbimi i përkthyesve) etj.

Tetë vjet më parë, në mënyrë që Fondi të sigurojë transparencën e punës filloi të funksionojë Ueb faqja jonë, si dhe shtypja e gazetës interne “Informator”. Në to disa vite me rradhë rregullisht në mënyrë kualitative dhe me kohë shpallen shtojca me materiale dhe vendime të cilat shqyrtohen dhe miratohen në seancat e Këshillit drejtues, si dhe nga mbledhjet me Shërbimin profesional – Qendra e Fondit, organizimin e pres konferencve dhe realizimin e projekteve pensionale. Shpallen tekste firmuese dhe komente nga puna e Shërbimit profesional të Fondit. Në bashkëpunimin cilësor me të gjitha shërbimet profesionale dhe seksionet në Fond, me çka përparohet ambienti i bashkëpunimit koordinativ dhe kënaqësia e shfrytëzuesve të shërbimeve.

Në vitin 2011, Grupi për komunikim aktivisht dhe drejtpërdrejtë mori pjesë në organizimin dhe realizimin e mbledhjeve të shumta në përbërje të zgjeruar, mbledhje, prezantime profesionale, ligjërime interaktive dhe aplikative, konferencë për shtyp, konferenca për bashkëpunim bilateral, për të cilët publiku dhe të punësuarit në Fond ishin informuar detajisht dhe me kohë.

Gjatë vitit 2013 janë dhënë 3 numra të gazetës interne për të punësuarit “Informator“, në të cilat faqe janë publikuar gjithsej 30 tekste. Ajo e cila duhet të nënvizohet në veçanti është se në vitin 2013 në gazetën mujore të LSHPM “Pensioner plus”, Fondi ishte i përfaqësuar, gjatë së cilës në 11 numra të gazetës janë shpallur 11 artikuj analitik të cilët e afirmojnë politikëm pensionale dhe punën e Fondit. Nëpërmjet të këtyre teksteve dhe komenteve, publiku në mënyrë të kontinuar ishte i njoftuar me punën e Këshillit drejtues të Fondit, investimet në

shtëpitë e pensionistëve dhe klubet, objektet për rekreacion të pensionistëve, aktivitetet e lidhura me rekreacionin klimaterik në banjë, harmonizimin e pensioneve, Fondin solidar, etj.

Ueb-faqja e Fondit të SPIM-së (www.piom.com.mk) është mënyrë më e rëndësishme dhe më bashkëkohore në komunikimin e Fondit me publikun. Vërtetimi për këtë është koncepti i rubrikave të shumta e cila është në funksion direkt të shfrytëzuesve, obliguesve, pensionistëve dhe të punësuarve në Fond. Nëpërmjet saj, në vitin 2013 janë shpallur të gjitha informacionet e duhura për çështje të veçanta praktike, por edhe vendosje të komunikimit të përhershëm, të hapur dhe reciprok ndërmjet Fondit dhe shfrytëzuesve të shërbimit.

Edhe në vitin 2013 në Fond vazhdoi të zbatohet projekti për shërbime cilësore që Fondi i jep shfrytëzuesve të tij, të cilët janë të shpallur në Ueb faqen e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, www.uslugi.gov.mk. Në vitin e kaluar nëpërmjet kësaj Ueb faqe nga qytetarët e RM-së deri te Fondi, janë parashtruar 165 pyetje nga fusha e realizimit të të drejtave nga sigurimi pensional dhe invalidor, të cilave më së voni në afat prej 5 ditësh u janë përgjigjur në mënyrë profesionale . Gjithashtu, në mbështetje me instrumentin “Ditari i qytetarit”, në hyrjen e Qendrës, filialet dhe ekspoziturat e Fondit janë vendosur kutitë me formularë – pyetësorë për qytetarët – shfrytëzues të shërbimeve tona të cilët i plotësojnë dhe paraqesin mendimin e tyre për punën, sjelljen, shërbimin dhe profesionalizmin e të punësuarve në Fond. Formularët e plotësuar, nga Qendra, filialet dhe ekspoziturat në mënyrë elektronike rregullisht janë dërguar deri te Ministria e shoqërisë së informacionit dhe administrimit për shqyrtim në seancat e Qeverisë së RM-së.

Në vitin 2013 Fondi i SPIM-së me përfaqësues të tij nga Gurpi për komunikim, së bashku me përfaqësues prej 8 institucioneve tjera, ishte pjesë e projektit të Ministrisë për informim shoqëror dhe administratë si dhe Qeveria e Republikës së Maqedonisë – Metodologjia “Barometër për cilësinë e institucioneve”, me qëllim sjelljen e matjes objektive të cilësisë të punës të institucioneve në administratë,

ndërsa në funksion të sigurimit të kontinuar të cilësisë së punës të administratës dhe mbështetje për producimin e shërbimeve më cilësore. Barometër për cilësi paraqet monitorimin dhe evaluimin e punës së institucioneve me qëllim që të gjenden dobësitë për të cilat duhet të ndërmerren masa për tejkalimin e tyre. I njëjti u zbatua në 2 mënyra: nëpërmjet vetëevaluimit (plotësimin e pyetësorit) dhe evaluim nga ana e Komisionit e përbërë nga anëtarë të Kabinetit të kryeministrit dhe të Ministrisë për informim shoqëror dhe administratë.

Në Fond në vitin 2013 rregullisht u përkthyen nga maqedonishtja në shqip të gjitha materialet e Këshillit drejtues, komisionet, Ueb faqja dhe dokumente të tjera nga puna e Shërbimit profesional të Fondit (Profili dhe Raporti vjetor), ndërsa botohej edhe “Informatori” në gjuhën shqipe. Kështu që në vitin 2013 janë përkthyer të gjitha materialet prej 22 seancave të mbajtura të Këshillit drejtues të Fondit, 30 tekste për “Informatorin”, më shumë lajmërimet për opinionin, tektet e shpallura në Ueb faqen e Fondit, ndërsa është realizuar edhe përkthim simultan në çdo seancë të Këshillit drejtues.

Gjithashtu në mënyrë aktive punonte edhe Komisioni për mbrojtjen e të drejtave për qasje publike deri te informacionet e Fondit, si ndërmjetësues gjatë realizimit të drejtës për qasje të lirë deri te informacionet e Fondit, si posedues i informacioneve. Për punën e këtij Komisioni për vitin 2013 është përgatitur Raport i cili është pjesë përbërëse nga Raporti vjetor i Komisionit për mbrojtjen e të dhënave për qasje publike të informacioneve pranë Qeverisë së Republikës së Maqedonisë.

Në vitin 2013, në mënyrë aktive veprohej pas ankesave dhe propozimeve të arritura në Fond përkatësisht udhëhiqej komunikim gojor për ankesat e parashtruara për të cilët menjëherë jepej përgjigje, si dhe korrespondencë me shkrim me bartësit e ankesave.

Në Fond, për shkak të komunikimit më të mirë me qytetarët, punon edhe Call-qendra, (02/15-215), e cila është e hapur për publikun ç’do ditë pune dhe

nëpërmjet së cilës jepen përgjigje në të gjitha pyetjet e parashtruara nga ana e personave fizik ose juridik.

V. REALIZIMI I TË DREJTAVE DHE ZBATIMI I SIGURIMIT PENSIONAL DHE INVALIDOR

1. Zgjidhja e kërkesave në shkallë të parë

Gjatë vitit 2013 në filialet e Shërbimit profesional të Fondit, janë parashtruar 31.228 kërkesa për realizimin e të drejtës për sigurim pensional dhe invalidor, prej të cilave 21.068 kërkesa të para për realizimin e të drejtës së pensionit (prej tyre 12.743 për pension pleqërie, 2.912 për pension invalidor dhe 5.413 për pension familjar), 2.825 kërkesa për realizimin e të drejtës së sigurimit invalidor (dëmtim fizik, nuk ekziston invaliditet, paaftësi profesionale për punë, paaftësi e përgjithshme për punë) dhe 7.335 kërkesa të përsëritura.

Tabela 20: Gjithsej numri i kërkesave të parashtruara dhe të zgjidhura sipas llojit, me gjendje më 31 dhjetor të vitit 2013

Nr. renor.	Përshkrimi	Kërkesa të pazgjidhura në fillim të vitit	Numri i kërkesave të parashtruara në vitin 2013	Gjithsej për zgjidhje	Kërkesa të zgjidhura	Struktura	Kërkesa të zgjidhura për 30 ditë	Struktura	Kërkesa jo të zgjidhura deri në fund të vitit	Struktura
1	Kërkesa të para për realizimin e pensionit	718	21.068	21.786	21.461	98,51	19.544	89,71	325	1,492
2	Kërkesa nga sigurimi invalidor	4	2.825	2.829	2.816	99,54	2.610	92,26	13	0,005

3	Kërkesa të ngelura	230	7.335	7.565	7.498	99,11	7.396	97,77	67	0,88
	Gjithsej	952	31.228	32.180	31.775	98,74	29.550	91,83	405	1,25
	Kërkesa të zgjidhura prej 35 deri 60 ditë sipas gjitha bazave						2.225	6,914		
	Gjithsej kërkesa të zgjidhura						31.775			


Gjatë vitit 2013 janë zgjidhur 31.775 kërkesa sipas gjitha bazave për realizimin e të drejtës nga sigurimi pensional dhe invalidor, prej të cilëve 21.461 kërkesa të para për realizimin e të drejtës së pensionit.

Në vitin 2013 me zbatimin e Projektit për mbështetje teknike për dizejnimin e proceseve të reja për realizimin e të drejtës dhe pagesën e pensioneve u soll proces plotësisht i automatizuar i punës. Në veçanti duhet që të theksohet se me angazhimin dhe organizimin e plotë në komisionet invalidore edhe pranë jo ekipimit të komisionit të mjekëve, me numër të reduktuar të resurseve rregullisht kryenin funksionin e tyre në interes të përfituesve të së drejtës dhe realizimin e azhurnimit në punë me zgjidhjen e lëndëve të prapambetura nga viti 2012 dhe siguruan shkurtimin e afateve të termineve minimale. Në vitin 2013, është arritur azhurnim në kohëzgjatjen e procedurës për vlerësimin e aftësisë për punë edhe në pjesën e rishikimit të menjëhershëm dhe në sjelljen e vendimeve. Nga gjithsej kërkesat e para të zgjidhura për pension invalidor (2.816) në afat prej 30 ditë janë zgjidhur 2.610 kërkesa, ndërsa 206 kërkesa janë zgjidhur në periudhë prej 35 ditë deri në 6 muaj.

Në vitin 2013, së bashku me kërkesat e bartura të vitit 2012, gjithsej për zgjidhje kishte 21.786 kërkesa të para prej të cilëve të zgjidhura janë 21.461 apo 98,5%. Procedura për zgjidhjen e kërkesave zgjat deri më 30 ditë dhe prej 35-60. Në afat prej 30 ditë janë zgjidhur 19.544 kërkesa apo 91,1%, ndërsa prej 35 deri 60 ditë janë zgjidhur 1.917 kërkesa apo 8,9%. Kërkesat të cilët janë plotësisht të kompletuara zgjidhen menjëherë (deri më 30 ditë), përderisa për lëndët jo plotësisht të kompletuara, procedura zgjat më shumë, gjegjësisht deri në sigurimin e të

dhënave nga parashtruesi i kërkesës për vërtetimin e stazhit të pensionit për personat të cilët kanë punuar në firmat private.

Në vitin 2013 nga gjithsej 21.461 kërkesa të para të zgjidhura, 12.969 kanë të bëjnë me pensionet e pleqërisë apo 60,43%, 2.984 apo 13,9% janë për pensione invalidiore dhe 5.508 kërkesa apo 25,67% për pensione familjare. Struktura e kërkesave të zgjidhura është paraqitur në grafikonin e mëposhtëm:



Në fund të vitit 2013 kishte 325 kërkesa të pa zgjidhura apo 1,5% nga gjithsej numri për zgjidhje. Mbetje më e madhe e kërkesave të pa zgjidhura ka në filialet edhe atë: Kumanovë, Shtip, Ohër, Kërçovë dhe Prilep, për shkak të mos kompletimit në lidhje me stazhin dhe pagat të cilat janë elemente të rëndësishme për realizimin e të drejtës së pensionit.


Numri i kërkesave të parashtruara për realizimin e të drejtës të sigurimit invalidor (dëmtim fizik, nuk ekziston invaliditet paaftësi profesionale për punë dhe paaftësi e përgjithshme për punë) në vitin 2013 arrin në 2.812 kërkesa dhe së bashku me 4 kërkesat e pazgjidhura nga viti 2012, gjithsej për zgjidhje kishte 2.816 kërkesa dhe 13 kërkesa të pazgjidhura deri në fund të vitit 2013.

Në vitin 2013, ishin të parashtruara 7.335 kërkesa të tjera dhe së bashku me 230 kërkesat e pazgjidhura nga viti i mëparshëm, gjithsej kërkesat arrijnë 7.565 kërkesa. Prej tyre të zgjidhura janë 7.498, ndërsa kanë mbetur për zgjidhje 67 kërkesa. Kërkesat e tjera të parashtruara i dedikohen ripërtrijtjes së procedurës për shkak të plotësimit të përcaktimit të vërtetuar për stazh pensional apo kontribut të paguar, për shkak të vendosjes të ndërprerë të pensionit prej më parë gjatë pagesës sipas gjitha bazave (për shkak të punësimit, vdekjes, ndërprerjes së shkollimit dhe etj.) për shkak të ndryshimeve në emër apo mbiemër të përfituesit të pensionit e cila më parë është paguar në emër të kujdestarit – të autorizuar, ndryshim i NVAQ të shfrytëzuesit të pensionit, për shkak të përfshirjes apo përjashtimit të një anëtari shfrytëzues i pensionit familjar, për shkak të sjelljes së një vendimi përfundimtar pas sigurimit të dëshmimeve dhe etj.

Gjithsej kërkesa të para për realizimin e pensionit të pleqërisë, invalide dhe pensionit familjar, kërkesa nga sigurimi invalidor, si dhe kërkesat e tjera, në vitin 2013, arrijnë 31.775 kërkesa dhe në krahasim me vitin 2012 (32.340) është reduktuar për 565 kërkesa, apo për 1,73%, dhe të njëjtat janë dhënë në tabelën në vijim:

Tabela nr. 21: Numri i gjithsej kërkesave të para të zgjidhura:

Lloji i pensionit	2012	2013	Indeks
Pension pleqërie	12.350	12.969	105,01
Pension invalidor	3.024	2.984	98,68
Pension familjar	5.476	5.508	100,58
Kompensim për sigurim invalidor	3.469	2.816	81,18
Kërkesa tjera	8.021	7.498	93,48
Gjithsej	32.340	31.775	98,25



Numri i kërkesave për pension pleqërie në vitin 2013 në raport me vitin 2012 është i zmadhuar për 619 apo 4,78%, për shkak të rritjes së numrit të kërkesave të parashtruara për realizimin e të drejtës së pensionit invalidor.

2. Raport mbi punën e Seksionit për normativë, monitorim dhe zbatimin e dispozitave juridike dhe për të vepruarit sipas parashtresave në vitin 2013

Seksioni për normativë, monitorimin dhe zbatimin e dispozitave juridike dhe për të vepruarit sipas parashtresave në përputhje me kompetencat për zbatimin e dispozitave dhe ofrimin e udhëzimeve për Filialet e Fondit për të vepruarit sipas lëndëve dhe përgjigjes së institucioneve dhe palëve i kryen aktivitetet e mëposhtme:

1. Në Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale janë parashtruar kërkesa për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për sigurim pensional dhe invalidor, kërkesa për të sqaruar mbi zbatimin e dispozitave të caktuara për një zbatim të saktë si dhe përgjigje ndaj pyetjeve të caktuara të Ministrisë.
2. Janë dërguar komente mbi Propozim ndryshimet e Ligjit për sigurim pensional dhe invalidor dhe Ligjit për punonjësit në sektorin publik. Për Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale janë përgatitur dhe dërguar 103

- shkresa si përgjigje e kërkesave tona dhe të tyre. Është dorëzuar kërkesë në përputhje me konstatimet e Entit shtetëror për revizion për një lidhje elektronike të Komisionit për revizion pranë Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale me Komisionin për vlerësimin e aftësisë për punë.
- Në bashkëpunim me Ministrinë janë përgatitur edhe ndryshimet e Statutit të Fondit të sigurimit pensional dhe invalidor të Maqedonisë.
3. Në lidhje me zbatimin e ndryshimeve të Ligjit për sigurim pensional dhe invalidor si dhe në pjesën e zbatimit të dispozitave të kategorive të veçanta të të siguruarve për shkak sjelljes elektronike të aktvendimeve për realizimin e të drejtave të sigurimit pensional dhe invalidor, në Sektorin e Teknologjisë Informatike janë parashtruar 52 kërkesa për intervenim në aplikacion me shabllone të reja të aktvendimeve për mënyrën e llogaritjes së bazës së pensionit.
 4. Është kryer inspektim në të dhënat nga Agjencia e Punësimit e Republikës së Maqedonisë në 1368 raste, shfrytëzues të pensionit, me qëllim që të kontrollohet nëse të njëjtit janë edhe shfrytëzues të pensionit edhe punonjës të siguruar. Pas përcaktimit të shfrytëzuesve të pensionit të cilët ishin edhe të punësuar janë dhënë udhëzime mbi sjelljen e aktvendimeve për të mohuar të drejtën e pensionit.
 5. Me kërkesë të filialeve të Fondit, janë dorëzuar 109 lëndë për të cilat janë dhënë udhëzime me shkrim për veprim ligjor sipas kërkesave për realizimin e të drejtës së pensionit , ndërsa në raste të caktuara edhe për ndërprerjen e të drejtës.
 6. Është përgjigjur mbi kërkesat nga Avokati i Popullit për 73 raste.
 7. Është përgjigjur mbi 6 kërkesat e Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe 9 përgjigje për Ministrinë e Shoqërisë Informatike dhe Administratës.
 8. Është parashtruar kërkesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë për të zhvilluar një takim të përbashkët dhe shkëmbimin e mendimeve në lidhje me zbatimin e aktgjykimeve të Gjykatës Administrative për shkak të diversitetit në vendim-marrjen e aktgjykimeve për të njëjtën punë juridike.
 9. Përgjigje për Zyrën e Presidentit të Republikës së Maqedonisë në 16 raste.
 10. Është bërë analizë e 83 lëndëve invalidore të marra nga Gjykata Themelore në Shkup të cilat ishin lëndë e një analize në procedurë penale dhe për të cilat është përcaktuar se bëhet fjalë për realizimin e të drejtës së pensionit invalidor duke u bazuar në marrjen e ryshfetit, janë dhënë shabllone të

aktvendimeve në filialet e Fondit për asgjësimin e aktvendimeve me të cilat është realizuar e drejta si dhe për të përpunuar një llogaritje për kthimin e pensioneve të paguara në mënyrë të paligjshme.

11. Është kryer kontroll mbi punën e filialeve dhe ekspoziturave të Fondit duke dhënë propozim-masa për përmirësimin e punës.
12. Gjatë vitit 2013 janë dorëzuar dy vendime për përcaktimin e vendeve të punës të cilave stazhi i sigurimit u llogaritet me kohëzgjatje të shtuar, edhe atë, për "Detonit" SHPKNJP – Radovish për 4 vende të punës dhe RZH "Kontrolli teknik" – Shkup për 1 vend pune. Janë dhënë përgjigje, sqarime të njësisve rajonale – 3, palë – 4, MPPS – 2, subjekte juridike – 3.
13. Është dorëzuar Informacion në MPPS me qëllim që të njoftohen se, miniera "Indominerale dhe metale" SHPK Probishtip nuk i paguan kontributet shtesë të sigurimit pensional dhe invalidor të cilët punojnë në vendet e punës të cilëve stazhi i sigurimit u llogaritet me kohëzgjatje të shtuar.
14. Me kërkesë të Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale është kryer inspektim në 23 lëndë invalide kontestuese. Është bërë regjistrimi i dokumentacionit të plotë dhe udhëheqjes së procedurës dhe procesverbalit për gjendjen e konstatuar faktike, i cili i është dorëzuar Ministrisë së lartëcituar.
15. Më 17 Nëntor të vitit 2013 hyri në fuqi Marrëveshja midis Qeverisë së Republikës së Maqedonisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës për konfirmimin e periudhave të sigurimit për realizimin e të drejtës së pensionit, janë përgatitur dhe ofruar udhëzime mbi zbatimin e kësaj Marrëveshjeje në filialet dhe ekspoziturat e Fondit.
16. Pas bisedimeve me përfaqësuesit e fondeve nga të gjitha ish republikat e Jugosllavisë ranë dakord për të shkëmbyer të dhënat për të gjithë shfrytëzuesit e ndjerë të pensionit të cilët janë shfrytëzues të pensionit nga dy republika.

Në vitin 2013 në mënyrë konstante, nga ana e Grupit për komunikim në Fond, janë dhënë përgjigje në pyetjet e parashtruara nga palët, pyetje që kanë të bëjnë me realizimin e të drejtave nga sigurimi pensional dhe invalidor.

3. Realizimi i të drejtave sipas marrëveshjeve ndërkombëtare

për sigurim social

Fondi i SPIM-së edhe në vitin 2013, vazhdoi t'i kryejë punët rrjedhëse si bartës në zbatimin e marrëveshjeve bilaterale për sigurim social dhe si organ kompetent për realizimin e të drejtave nga sigurimi pensional dhe invalidor gjatë zbatimit të marrëveshjeve ndërkombëtare për sigurim social.

Gjatë vitit 2013, Fondi i SPIM-së merrte pjesë me përfaqësues të tij në negociatat shtetërore për lidhjen e marrëveshjeve ndërkombëtare për sigurim social edhe atë:


- Në mars të vitit 2013 në Shkup u mbajt raundi i dytë i bisedimeve ndërmjet delegacionit maqedonas dhe atij shqiptarë në të cilin vazhdoi shqyrtimi i projekt- tekstit të Marrëveshjes për sigurim social ndërmjet Republikës së Maqedonisë dhe Republikës së Shqipërisë;
- Në shtator të vitit 2013, gjithashtu, në Shkup u mbajtën bisedime ndërmjet delegacionit maqedonas dhe atij nga Republika e Sllovakisë në lidhje me zbatimin e Marrëveshjes për sigurim social ndërmjet Republikës së Maqedonisë dhe Republikës së Sllovakisë;
- Më 25 dhe 26 Shkurt të vitit 2013, në Minhen të Gjermanisë u mbajtën ditë këshilluese ndërmjet përfaqësuesve të Fondit të sigurimit pensional dhe invalidor të Maqedonisë dhe bartësit gjerman të sigurimit social në të cilat qytetarët morrën përgjigjet nga ana e personave profesional të cilët punojnë në zbatimin e Marrëveshjes për sigurim social të lidhur ndërmjet të dy vendeve;
- Më 22 Maj të vitit 2013, në Shkup u mbajt një takim ndërmjet përfaqësuesve të Fondit të sigurimit pensional dhe invalidor të Maqedonisë dhe bartësit Holandez të sigurimit social për zbatimin e Marrëveshjes për sigurim social ndërmjet Qeverisë së Maqedonisë dhe Holandës. Në këtë takim janë shqyrtuar edhe formularët dygjuhësorë për zbatimin e marrëveshjes;

- Më 8 dhe 9 Tetor të vitit 2013, në Shkup u mbajtën ditë këshilluese ndërmjet përfaqësuesve të Fondit të sigurimit pensional dhe invalidor të Maqedonisë dhe sigurimit social gjerman në filialet në Tetovë dhe Gostivarë në të cilat takime qytetarët morrën këshilla nga persona profesional, të cilët punojnë në zbatimin praktik të Marrëveshjes për sigurim social të lidhur midis dy vendeve;
- Më 24 dhe 25 Tetor në Podgoricë – Mal të Zi u mbajt takimi i 4 (katërt) në nivel të drejtorëve të fondeve, enteve të ish-republikave jugosllave në lidhje me shkëmbimin elektronik të të dhënave, problemet dhe çështjet gjatë zbatimit të marrëveshjeve për sigurim social;
- Më 19 dhe 20 Nëntor të vitit 2013, në Shkup u mbajtën bisedime ndërmjet organit Maqedonas dhe atij Kroat në lidhje me fushën e sigurimit pensional dhe invalidor për zbatimin e Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Maqedonisë dhe Republikës së Kroacisë për sigurim social.

Në Seksionin për zbatimin e marrëveshjeve ndërkombëtare për sigurim social në Qendrën e Shërbimit profesional, në vitin 2013, nga të siguruarit apo nëpërmjet bartësve të huaj të sigurimit janë parashtruar 3013 kërkesa të para dhe 1421 kërkesa për përsëritjen e procedurës, aktvendime ndërprerëse për pensionin e pleqërisë dhe aktvendime ndërprerëse për shumën më të ulët të pensionit, ndërsa në vitin 2012, 5214 kërkesa për realizimin e të drejtave të sigurimit pensional dhe invalidor, përkatësisht 780 kërkesa më pak apo 15% më pak kërkesa. Përveç këtyre, në vitin 2013, kanë mbetur të pa zgjidhura edhe 1024 kërkesa nga viti 2012, kështu që gjithsej numri i kërkesave për zgjidhje arrin 5.458. Nga gjithsej numri i kërkesave janë zgjidhur dhe kontrolluar 4.512 kërkesa apo 90,9%, ndërsa të pazgjidhura në fund të vitit kanë mbetur 946 kërkesa apo 17,3%.

Tabela nr.22: Numri i kërkesave për zgjidhje dhe kërkesa të zgjidhura

Nr.ren.	Përshkrim	Viti 2012	Viti 2013	Indeksi 2013/2012
1	Kërkesa të bartura	776	1.024	131,96
2	Kërkesa të pranuar	5.214	4.434	85,04
3	Gjithsej kërkesa	5.990	5.458	91,12
4	Kërkesa të zgjidhura	4.966	4.512	90,86
5	Kërkesa të pa zgjidhura	1.024	946	92,38



Numri i kërkesave të zgjidhura në vitin 2013 në krahasim me vitin 2012 është reduktuar për 454 kërkesa apo për 9,9%, ndërsa kërkesat e pazgjidhura në fund të vitit 2013 arrijnë 946 kërkesa dhe në krahasim me vitin 2012 janë reduktuar për 78 kërkesa.

Nga të dhënat e lartë përmendura mund të konstatohet se, gjatë këtij viti kërkesat e parashtruara janë reduktuar në raport të vitit 2012, gjithashtu është reduktuar edhe numri i kërkesave të zgjidhura.

Gjatë vitit 2013 janë kryer edhe punë të tjera, edhe atë:

- Për bartësit e huaj të sigurimit janë përpunuar formularë dygjuhësor dhe janë parashtruar 1.777 kërkesa për pension;
- Pas kërkesave të parashtruara për realizimin e të drejtës së pensionit, është udhëhequr korrespondencë me palët, filialet dhe bartësit e huaj me qëllim të kompletimit të kërkesave dhe realizimit të shpejtë të të drejtave nga 5.794 korrespondenca;
- Është ngritur procedurë sipas 2.383 kërkesave për konfirmimin e stazhit pensional të mbushur jashtë vendit për të siguruarit të cilët nuk realizojnë të drejtën e pensionit dhe në mënyrë reciproke për nevojat e bartësve të huaj është konfirmuar stazhi i Maqedonisë me formularë dygjuhësor;
- Në Komisionin invalidor të shkallës së parë për vlerësimin e aftësisë për punë janë dhënë 312 lëndë;
- Është përgjigjur në të gjitha parashtruesat e arritura.

Në vitin 2013, gjithashtu në të gjitha filialet e Fondit u mbajtën Ditët e hapura – takim me qytetarët "Ditë për Ju" me qëllim që të tejkalohen problemet me të cilat ballafaqohen qytetarët në realizimin e të drejtave të sigurimit pensional dhe invalidor. Në këto takime morën pjesë edhe përfaqësues nga Seksioni për zbatimin e marrëveshjeve ndërkombëtare për sigurim social në mënyrë që t'u ndihmohet atyre qytetarëve të cilët kishin realizuar stazh jashtë vendit për të realizuar të drejtën e sigurimit social sipas këtyre marrëveshjeve.

Në zbatimin e drejtpërdrejtë të marrëveshjeve ndërkombëtare në Fond, gjatë vitit 2013 është kryer përkthim i 8.984 faqeve (nga frëngjishtja në maqedonisht dhe anasjelltas 3.968 faqe, nga gjuha angleze në atë maqedonase dhe anasjelltas, 1.569 faqe prej italishtes në maqedonisht dhe anasjelltas, 604 faqe dhe 2.843 faqe prej gjermanishtes në maqedonisht). Për nevojat e bartësve të huaj për sigurim social janë shfrytëzuar edhe përkthyes nga jashtë për përkthimin e 342

faqeve nga gjuha çeke, polake, hungareze, bullgare, suedeze, turke, sllovae, holandeze, greke, rumune, gjuha flamene, daneze, angleze dhe nga gjuha sllovene në atë maqedonase, janë plotësuar formularë njëgjuhësor për pensione, janë dhënë vërtetime për jetë, janë përkthyer formularë për bisedime sipas marrëveshjeve të reja si dhe detyra të tjera nga fusha e këtij sigurimi.

4. Puna e Seksionit për vlerësimin e aftësisë për punë

Në procedurën e realizimit të të drejtave nga sigurimi pensional dhe invalidor rëndësi të madhe ka vlerësimi i aftësisë për punë, sepse në bazë të invaliditetit dhe dëmtimit fizik realizohen edhe të drejtat materiale afatgjate nga fusha e sigurimit pensional dhe invalidor.

Në mbështetje të Ligjit për sigurim pensional dhe invalidor, tek i siguruari ekziston invaliditet kur për shkak ndryshimit të përhershëm të gjendjes shëndetësore i shkaktuar me lëndime në punë, sëmundje profesionale, lëndim jashtë punës apo me sëmundje që nuk mund të shmanget me mjekim apo me masa të rehabilitimit mjekësor do të shfaqet reduktim apo humbje e aftësisë për punë për kryerjen e punëve në vendin e punës, ku i siguruari ka qenë i sistemuar para shkaktimit të invaliditetit.

Invaliditeti si një bazë për realizimin e të drejtës së sigurimit pensional dhe invalidor tek i siguruari përcaktohet në Fond nëpërmjet Komisionit për vlerësimin e aftësisë së punës në bazë të një inspektimi të zbatuar në dokumentacionin mjekësor dhe në dokumentacion tjetër si dhe në bazë të një kontrolli të drejtpërdrejtë të të siguruarit.

Në vitin 2013, Komisioni për vlerësimin e aftësisë për punë punonte në tre përbërje me nga dy mjekë – specialistë për dallim nga viti 2012 kur punonte në 2 përbërje me nga dy mjekë. Komisioni për kontrollin e detyrueshëm mjekësor punonte me stafin e përhershëm ekzistues në dispozicion të mjekëve të specializuar, duke pasur parasysh që i njëjti mjek të mos merr pjesë në punën e dy

komisioneve atëherë kur bëhet ekspertizë për lëndën e njëjtë. Komisioni për përcaktimin e kompletshmërisë dhe rregullshmërisë së dokumentacionit punonte me një anëtarë, mjek specialist.

Komisioni si një organ i vetëm kompetent pas kontrollit të zbatuar, sjell Konstatim, vlerësim dhe mendim mbi paaftësinë e përgjithshme për punë, paaftësinë profesionale për punë me të drejtë të kualifikimit apo rikualifikimit të të siguruarit për përqindjen e dëmtimit fizik, Konstatim për përcaktimin e paaftësisë për punë, realizimin e të drejtës së pensionit familjar të një anëtari të familjes si dhe Konstatim për përcaktimin e invaliditetit tek personat me invaliditet, me qëllim që i njëjti të punësohet në Shoqërinë tregtare mbrojtëse, rrezik nga shkaktimi i invaliditetit etj.

Komisioni për vlerësimin e aftësisë për punë sillte Konstatim, vlerësim dhe mendim edhe në lëndët tek të cilat zbatohet Marrëveshje bilaterale për sigurim social.

Në vitin 2013, në Komisionin invalidor të shkallës së parë kanë arritur dhe janë verifikuar 6.679 lëndë për vlerësimin e aftësisë për punë dhe të njëjtat krahasuar me vitin 2012, përkatësisht 6.090 lëndë janë rritur për 589 lëndë apo 9,7%.

Lëndët e pakompletuara që arrijnë në 1289, përmes Komisionit për plotësinë dhe rregullshmërinë e lëndëve janë kthyer në shërbimet profesionale (filialet) apo Qendrën e Fondit si dhe tek të siguruarit dhe u është kërkuar rikompletimi i dokumentacionit me qëllim që të silltet një Konstatim adekuat, vlerësim dhe mendim sipas kërkesës. Komisioni në rast të dokumentacionit të pa kompletuar kërkon dorëzimin e dokumenteve të cilat mungojnë. Për dokumentet e pa kompletuara, mendohet në lëndët pa dokumentacion mjekësor përkatës, mungesa e Formularit nr. 3, Propozim për ekspertizë mjekësore nga mjeku amë, Formularë A1, kushtet për punë dhe detyrat e punës.

Një pjesë e dokumentacionit mjekësor është me afat të skaduar ose me kërkesa të parakohshme për rivlerësimin e aftësisë për punë dhe një pjesë e lëndëve janë kthyer në filialet, sepse të siguruarit nuk u janë përgjigjur dy apo më shumë ftesave nga ana e Komisionit. Përveç kësaj nevojitet edhe kompletimi i lëndëve me listë kompjuterike të M-4, të dhënat për përcaktimin e stazhit.

Komisioni për kompletimin dhe rregullshmërinë e lëndëve në vitin 2013, ka realizuar aktivitetet e mëposhtme:

1. Kërkesa të pranuar dhe regjistruara 6.679
2. Lëndë të kompletuara dhe palë të ftuar 7.880, prej të cilave 1.201 janë të bartura nga viti i kaluar
3. Lëndë të kopletuara dhe të ftuar sipas kontrollit të detyrueshëm mjekësor - 732 lëndë
4. Letrat e dërguara palëve për rikompletimin e dokumentacionit të punës dhe atij mjekësor sipas 847 kërkesave
5. Letrat e dërguara në Njësinë rajonale për shkak rrefuzimit të kërkesës dhe për shkak mungesës së dokumentacionit të punës dhe atij mjekësor – 85 kërkesa.

Komisioni për vlerësimin e aftësisë së punës në vitin 2013 nga viti 2011 kishte 1201 lëndë të bartura për zgjidhje në gjithsej 7880 lëndë të kompletuara për zgjidhje nga viti 2012 dhe në bazë të gjendjes së përcaktuar faktike në vitin 2013 solli gjithsej 7.201 konstatime, ndërsa në vitin 2012, 6491 konstatime, që është më shumë për 710 konstatime, apo për 10,9% si rezultat i organizimit efikas dhe angazhimit plotësues dhe përpjekjet mbinjerëzore të anëtarëve të këtij Komisioni.

Nga gjithsej numri i kërkesave të parashtruara, Komisioni solli 5.185 konstatime për vlerësimin e aftësisë për punë, në vitin 2012 kishte 5647 konstatime, 92 konstatime për realizimin e të drejtës sipas marrëveshjeve ndërkombëtare,

ndërsa në vitin 2012, 114 konstatime, 1 konstatim për mbrojtje shëndetësore në vitin 2012, 415 konstatime për përcaktimin e përqindjes së dëmtimit fizik si e drejtë e vetme, përderisa në vitin 2012 kishte 401 konstatime të këtilla.


Struktura dhe lloji i kërkesave të ekspertuara në vitin 2013 paraqitet në vijim:

- 1.539 kërkesa apo 32,3% për realizimin e të drejtës së pensionit (në vitin 2012, 1941 kërkesa) edhe atë: 977 kërkesa apo 63,5% për paaftësi të përgjithshme, ndërsa për punë në vitin 2012 1.269 kërkesa, 7 kërkesa apo 0,5% edhe më tej paaftësi e përgjithshme për punë, ndërsa në vitin 2011, 2 kërkesa dhe 555 kërkesa apo 36,0% paaftësi profesionale për punë me të drejtë të pensionit, ndërsa në vitin 2012, 670 kërkesa,
- 89 kërkesa apo 1,9% për aftësinë e zvogëluar të punës me orar të shkurtuar pune, ndërsa në vitin 2011, 102 kërkesa,
- 85 kërkesa apo 1,8% për ndryshimin e vendit të punës, ndërsa në vitin 2012, 162 kërkesa,
- 311 kërkesa apo 6,5% edhe më tej aftësi e zvogëluar për punë, ndërsa në vitin 2012, 289 kërkesa,
- 1 kërkesë apo 0,02% mjekimi nuk ka mbaruar, ndërsa në vitin 2012, 89 kërkesa,
- 1.919 kërkesa apo 40,2% - nuk ekziston invaliditet, ndërsa në vitin 2012 , 1749 kërkesa,
- 27 kërkesa apo 0,3% - raste të tjera, ndërsa në vitin 2012, 17 kërkesa,
- 461 kërkesa apo 9,6% kontrole të serishme, ndërsa në vitin 2012, 527 kërkesa,
- 246 kërkesa apo 4,9% për pension familjar, ndërsa në vitin 2012 , 255 kërkesa,
- 92 konstatime apo 2,2% për bartësit e huaj, ndërsa në vitin 2012, 114 konstatime.

Tabela nr. 23: Kërkesat e zgjidhura për vlerësimin e aftësisë për punë sipas llojit, në vitin 2013 dhe 2012, janë paraqitur në tabelën vijuese:

Nr.rendor	Lloji i rasteve	Viti 2012		Viti 2013		Indeksi 2013/2012
		numri	struktura	numri	struktura	
1	Paaftësi e përgjithshme për punë	1941	37%	1539	32,3	79,3
2	Orar i shkurtuar i punës	102	1,9	89	1,9	87,3
3	Ndryshimi i punës	162	3,1	85	1,8	52,5
4	Edhe më tej aftësi e zvogëluar për punë	289	5,5	311	6,5	107,4
5	Mjekimi nuk ka mbaruar	89	1,7	1	0	0
6	Nuk ekziston invaliditetet	1749	33,4	1919	40,2	109,7
7	Raste të tjera	17	0,3	27	0,6	158,8
8	Kontrolle të serishme	527	10	461	9,6	87,5
9	Pension familjar	255	4,9	246	5,2	96,5
10	Konstatime për bartësit e huaj	114	2,2	92	1,9	80,7
	GJITHSEJ I	5.245	100	4770	100	158,3
1	Mbrojtje shëndetësore	1	0,1	0	0	0
2	Dëmtim fizik	401	32,2	415	35,9	103,5
3	Kontrolli mjekësor	844	67,7	741	64,1	87,8
	GJITHSEJ II	1.246	100	1156	100	92,8
	GJITHSEJ (I+II)	6.491	100	5.926	100	91,3

Struktura e kërkesave të ekspertuara mund të shihet në grafikonin vijues:



Nga të dhënat në tabelë për kërkesat e zgjidhura nga ana e Komisionit për vlerësimin e aftësisë për punë i cili në vitin 2013 ka punuar me numër të zmadhuar të mjekëve, puna zhvillohej në kohë, ndërsa lëndët janë zgjidhur më shpejtë me 91,3% kërkesa të zgjidhura në raport të gjithsej kërkesave të parashtruara.

Tabela nr. 24. Numri i konstatimeve të sjella për vlerësimin e aftësisë për punë sipas viteve paraqitet në vazhdim:

Viti	Vlerësimi i aftësisë për punë	Dëmtim trupor	Kujdesi dhe ndihma nga ndonjë person tjetër	Kërkesa të tjera	Gjithsej
1991	15.074	498	1.448	11.191	18.211
1992	13.080	359	1.209	1.105	15.761
1993	14.347	258	1.523	457	16.585
1994	13.114	327	1.783	558	15.782
1995	12.529	323	3.128	726	16.706
1996	10.773	315	5.157	845	17.090
1997	13.493	458	6.088	475	20.514
1998	13.796	510	7.057	414	21.777
1999	11.940	492	9.380	383	22.195
2000	10.738	467	11.357	379	22.941
2001	11.557	436	13.441	220	25.654
2002	10.530	423	16.364	277	27.594
2003	10.762	456	14.090	317	25.625
2004	8.936	421	15.544	238	25.139
2005	8.770	432	15.797	146	25.145
2006	8.450	402	13.273	293	22.418
2007	7.397	345	-	963	8.705
2008	6.605	297		1.689	8.591
2009	6.221	358		1.069	7.648
2010	4.479	254		1.110	5.843

2011	3.225	201		561	3.987
2012	5.131	401		959	6.491
2013	4.678	415		833	5.926

Sipas të dhënave në tabelë del se në vitin 2013 ka reduktim të konstatimeve të sjella për vlerësimin e aftësisë për punë në raport të vitit paraprak.

Kur bëhet fjalë për pension të përkohshëm invalidor dhe për procedurën e kontrollit të detyrueshëm mjekësor, vepron Komisioni për kontrollin e detyrueshëm mjekësor të shfrytëzuesve të pensionit të përkohshëm invalidor, përkatësisht pensionit familjar. Në periudhën prej 01.01. deri më 31.12.2013 ky Komision ka bërë ekspertizë në 741 raste, ndërsa në vitin 2012 në 844 raste dhe ka sjell po aq konstatime përkatëse.

Revizion për të gjitha konstatimet e Komisionit për vlerësimin e aftësisë për punë me të cilat është përcaktuar invaliditet, përkatësisht paaftësi për punë si dhe në bazë të zgjidhjes së rastësishme dhe revizion në konstatimet negative, kryen Komisioni për revizion të konstatimit, vlerësimit dhe mendimit për përcaktimin e invaliditetit, përkatësisht paaftësisë për punë i themeluar nga Ministri i Punës dhe Politikës Sociale.

Në vitin 2013, Komisioni për vlerësimin e aftësisë për punë i ka dorëzuar Komisionit për revizion pranë MPPS-së gjithsej 3.946 konstatime (2.079 pozitive dhe 1.867 negative). Prej këtyre 1.867 konstatimeve negative të dorëzuara, Komisioni për revizion përcaktoi 1.619 konstatime apo 86,7% nga gjithsej numri, ndërsa nuk ka përcaktuar 248 konstatime apo 13,3% të cilat janë me të drejtë të caktuar të pensionit.

Gjithashtu, prej 2.079 konstatimeve pozitive të dorëzuara në Komisionin për revizion pranë Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale, Komisioni përcaktoi 2.076 konstatime apo 99,9%, ndërsa nuk ka përcaktuar 3 konstatime apo 0,01%.

Në vitin 2013, Komisioni për kontrollin e detyrueshëm mjekësor ka kryer 741 kontrolle mjekësore të shfrytëzuesve të pensionit të përkohshëm invalidor,

përkatësisht pensionit familjar të cilat janë dorëzuar në revizion në Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale. Komisioni për revizion përcaktoi 688 konstatime apo 92,8%, ndërsa nuk përcaktoi 53 konstatime apo 7,2%. Pikërisht, prej 422 konstatimeve të dërguara pozitive, të sjella nga Komisioni për kontrollin e detyrueshëm mjekësor, Komisioni për revizion përcaktoi të gjitha 422 konstatimet apo 100%. Gjithashtu, Komisioni për kontrollin e detyrueshëm mjekësor i dërgoi Komisionit për revizion edhe 319 konstatime negative prej të cilave 266 konstatime janë përcaktuar apo 83,4%, ndërsa nuk janë përcaktuar 53 konstatime apo 16,6%.

5. Evidentimi amë

Në vitin 2013, Shërbimi profesional i Fondit në pjesën e evidentimit amë zbatoi detyrat që dalin nga puna e vazhdueshme e Shërbimit dhe detyrat që kanë të bëjnë me zbatimin e të gjitha proceseve të domosdoshme për funksionimin e reformave në sistemin pensional.

Në Qendër, filialet dhe ekspoziturat e Fondit janë zhvilluar aktivitete të lidhura me sigurimin e bazave të sakta të azhurnuara të të dhënave për të siguruarit dhe obliguesit për pagesën e kontributeve si dhe për shfrytëzuesit e të drejtës të sigurimit pensional dhe invalidor. Gjithashtu, Shërbimi profesional i evidentimit amë morri pjesë në mënyrë aktive dhe bashkëpunonte me shërbimet e tjera në Fondin e sigurimit pensional dhe invalidor të Maqedonisë. Gjatë periudhës raportuese, në veçanti, janë theksuar aktivitetet e mëposhtme:

1. Përgatitja e kërkesave afariste mbi ndryshimin dhe plotësimin e aplikacioneve për udhëheqjen e evidencave mbi të siguruarit, obliguesit dhe shfrytëzuesit e të drejtës të SPI-së.

2. Lidhje e marrëveshjeve për bashkëpunim dhe shkëmbimin e të dhënave me institucionet e tjera.
3. Pjesëmarrje në zbatimin e shkëmbimit të të dhënave me institucionet me të cilat kanë nënshkruar marrëveshjen për bashkëpunim.
4. Zbatim i kontrollit, mbikëqyrjes dhe instruksionit në filialet dhe ekspoziturat e Fondit në pjesën e shërbimeve të evidentimit amë.
5. Përgatitje e lajmërimeve për filialet dhe ekspoziturat mbi çështjet që përfshihen në fushën e evidentimit amë.
6. Bashkëpunimi i Fondit me institucionet e ndërlidhura me sistemin e reformuar pensional – antarësim në shtyllën pensionale private dhe mirëmbajtje e regjistrit të anëtarëve të fondeve pensionale private.
7. Të vepruari sipas kërkesave për monitorimin dhe sigurimin e kopjeve të fletëparaqitjeve origjinale të mikrofilmuara.

Gjatë vitit 2013, si të siguruar aktiv për të cilët janë paraqitur të dhënat për pagën dhe kontributin e llogaritur janë evidentuar 526.909 të siguruar. Sipas përndamjes në bazën për pranim në sigurimin pensional dhe invalidor, numri më i madh, përkatësisht 491.432 të siguruar kanë bazën e sigurimit.

Në raport të numrit të obliguesve aktiv për paraqitjen e të dhënave të cilët gjatë vitit 2013 kanë dorëzuar të dhënat për pagë dhe kontributin e paguar në evidencë janë regjistruar 70.464 obligues.

Me analizat e bëra në vitin 2013 është kryer saktësimi i të dhënave të përmbajtura në evidencën e Fondit, posaçërisht në raport të të dhënave për obliguesit e pagesës së kontributeve.

Gjatë kësaj është bërë krahasimi i të dhënave për M11 fletëparaqitjet e regjistruara për obliguesit e pagesës së kontributeve me të dhënat mbi subjektet e fshira afariste që janë marrë nga Regjistri qendror.

Si rezultat i këtij krahasimi janë pasivizuar ata obligues që duhej të paguanin kontributet dhe të cilët nuk kanë paraqitur me kohë ndërprerjen e punës në Fond përmes fletëparaqitjeve përkatëse M11.

Sipas analizës së të dhënave të regjistruara në Evidentimin amë, gjatë vitit 2013 janë përpunuar 869.158 fletëparaqitje me të dhëna mbi stazhin e sigurimit, pagat dhe kompensimet, përkatësisht bazat e sigurimit.

Nga gjithsej 869.158 M4 fletëparaqitjet e regjistruara me të dhëna për stazhin e sigurimit dhe pagat për vitin 2012, 307.778 fletëparaqitje ju dedikohen 507.061 të siguruarve që ishin të regjistruar në vitin 2012.

Në varësi të mënyrës me të cilën obliguesit për pagesën e kontributeve i kanë paraqitur të dhënat (në mënyrë elektronike apo përmes fletëparaqitjeve) ky numër i fletëparaqitjeve përfshin:

- 623.804 fletëparaqitje që janë pranuar në mënyrë elektronike, përkatësisht janë gjeneruar dhe pastaj janë përcaktuar. Këto të dhëna kanë të bëjnë me periudhën pas vitit 2006, kur të dhënat për stazhin e sigurimit dhe pagat janë pranuar në mënyrë elektronike. Për vitin 2012 janë gjeneruar 307.778 fletëparaqitje, ndërsa 316.026 fletëparaqitjet e tjera kanë të bëjnë me vitet prej 2006 deri më 2011 dhe vitin 2013.
- 245.354 fletëparaqitje janë regjistruar në mënyrë interaktive përmes formularëve M4, nga ana e referentëve në shërbimet e evidentimit amë (për periudha më të vjetra para vitit 2006), në sistemin e përpunimit automatik të të dhënave.

6. Pagesa e pensioneve

Një nga funksionet primare të Fondit në zbatimin e sigurimit pensional dhe invalidor është pagesa e përfitimeve pensionale të shfrytëzuesve të pensionit.

Sikurse vitin e kaluar ashtu edhe në vitin 2013 në javën e parë të muajit është bërë pagesa e pensioneve për muajin paraprak, ndërsa përpunimi i pensioneve është bërë në bashkëpunim me Sektorin e informatikës.

Në vitin 2013 është kryer harmonizim i rregullt i pensioneve në mbështetje me dispozitat ligjore, edhe atë: 1,15% prej 1 janarit, harmonizim plotësues prej 5%, përkatësisht në shumë nominale prej 550 denarë nga muaji Shkurt për të gjithë shfrytëzuesit e pensionit të cilët të drejtën e kanë realizuar në muajin Shkurt të vitit 2013 dhe 0,75% prej 1 Korrikut të vitit 2013.

Gjatë këtij viti, Fondi kryente pagesën e shfrytëzuesve të pensionit dhe, gjithashtu edhe të shfrytëzuesve të dëmtimit fizik.

Pavarësisht pagesës së rregullt, Fondi kryente edhe pagesën mujore të shfrytëzuesve të ndjerë të pensionit deri në ditën e vdekjes, ndërsa me kërkesë të pasardhësve është bërë pagesë e llogaritjeve të tilla dhe dallimeve sipas aktvendimit për një periudhë të kaluar.

Për të gjithë shfrytëzuesit e rinj të pensionit, Seksioni për likuidimin dhe pagesën e përfitimeve pensionale formoi dosje financiare mbi të drejtën e parë të shfrytëzuesit të pensionit, kontrollin e tyre dhe përcaktimin e pagesës.

Fondi në vitin 2013, përveç pagesës së pensioneve kryente edhe pagesën e pensioneve për shfrytëzuesit e pensionit të Maqedonisë me vendbanim jashtë Republikës së Maqedonisë, me çka kishte edhe pagesë të veçantë për ish republikat e Jugosllavisë dhe pagesë të veçantë për pensionistët të cilët jetojnë jashtë ish republikave Jugosllave, për shfrytëzuesit e rinj të pensionit janë hapur dosje financiare dhe gjithashtu është bërë kontrolli i të njëjtave, llogaritje, likuidim dhe kontrolli i të gjitha aktvendimeve për ripërtëritje, ri pensionim, aktvendime ndërprerëse të cilat janë dorëzuar nga filialet e Fondit si dhe kontrolli i një numri të madh të aktvendimeve ekzekutive që janë dorëzuar nga gjykatat dhe ekzekutuesit, përfshirje, përjashtim dhe evidentimi i ndryshimeve në shumat e pensioneve sipas bazave të ndryshme.

Në mbështetje të Ligjit për sigurim pensional dhe invalidor , shfrytëzuesve të cilët jetojnë jashtë Republikës së Maqedonisë u janë dorëzuar njoftime që të parashtrojnë vërtetime për jetë për vazhdimin e të drejtës së pagesës së pensionit. Prej 01.07.2013 pushon pagesa e pensioneve për të gjithë shfrytëzuesit e pensionit të cilët jetojnë jashtë Vendit në mbështetje të marrëveshjeve të lidhura për sigurim social dhe nevojës së Fondit të SPIM-së dhe të cilët nuk kanë dorëzuar vërtetim për jetë, gjithashtu edhe pensionistët të cilëve pensioni ju paguhet nëpërmjet personit të autorizuar dhe për personat me paaftësi të përhershme të cilët pensionin e pranojnë nëpërmjet një kujdestari në mbështetje të nenit 141 paragrafi 2 nga Ligji për sigurim pensional dhe invalidor, për shkak kontrollit të pagesës së pensionit sepse pagesa bëhet nëpërmjet një personi tjetër.

Për të gjithë shfrytëzuesit – fëmijë të pensionit familjar më të moshuar se 15 vjet të cilët kanë dorëzuar vërtetime shkollore deri më 01.09.2013 për nxënës, përkatësisht deri më 01.10.2013 për studentë, e drejta e shfrytëzimit të pensionit u është vazhduar përderisa për të tjerët të cilët nuk kanë dorëzuar vërtetime, pensioni pushon deri sa të dorëzohen vërtetimet shkollore. Në mbështetje të nenit 61 paragrafi 1 nga Ligji për sigurim pensional dhe invalidor, është zbatuar përfshirja e mbajtjes së një shume të caktuar nga pensioni sipas bazave të ndryshme (aktvendime gjyqësore dhe aktvendime tjera), mbajtje nga Seksioni për punë juridike dhe të përgjithshme si dhe përjashtimi i pagesës së pensionit për shfrytëzuesit e pensionit të cilët janë në marrëdhënie pune. Me Sektorin e informatikës dhe Seksionin për evidentimin amë është kryer dizajnim, përpunim, testim dhe shfrytëzimi i aktvendimeve aplikative mbi lëshimin e vërtetimeve për llogarinë e transaksionit gjatë parashtrimit të kërkesës për realizimin e të drejtës së pensionit, është kryer administrim i lëndëve pensionale, nga MPB-ja janë siguruar lista për shfrytëzuesit e ndjerë dhe të zhvendosur të pensionit, ndërsa për shfrytëzuesit e zhvendosur është paguar pension në një shumë të caktuar me Ligj.

Në vitin 2013 rregullisht është kryer dorëzimi i të dhënave për ngritjen e procedurës gjyqësore apo marrëveshje me palët. Në bashkëpunim me Shërbimin juridik dhe Seksionin për evidentimin amë rregullisht janë bërë llogaritje për dëme në bazë të stazhit fiktiv po qe se konstatohen me kontrolle, ndërsa të gjitha pensionet e këtilla kanë pushuar deri në momentin e pagesës së borxhit.

Në vitin 2013 Seksioni për likuidimin e përfitimeve pensionale i ka dorëzuar Seksionit për punë pronësoro juridike 605 lëndë për dëme sipas të gjitha bazave dhe është kryer edhe harmonizim i rregullt i të dhënave ndërmjet Seksionit për likidaturë, Seksionit për punë pronësoro juridike dhe Seksionit të kontabilitetit dhe pagesave.

7. Puna pronësoro juridike

Gjatë vitit 2013 në Shërbimin profesional të Fondit për punë juridike në periudhën prej 01.01.2007 deri më 31.12.2013 janë evidentuar gjithsej 6.427 lëndë në shumë prej 402.271.1996,00 denarë prej të cilave kanë përfunduar 3.281 lëndë në shumë prej 144.621.962,00 denarë.

Në përpunim gjenden gjithsej 3.146 lëndë në shumë prej 257.650.034,00 denarë.

Në vitin 2013 janë evidentuar 687 lëndë në bazë të dëmeve në baza të ndryshme prej të cilave Fondi kërkon shumë prej 36.703.589,00 denarë, prej të cilave kanë përfunduar 222 lëndë në shumë prej 11.364.518,00 denarë.

Më së shumti janë regjistruar lëndë – dëme në bazë të pensioneve të ndërprera familjare, edhe atë 363 lëndë në shumë prej 24.881.395,00 denarë prej të cilave kanë përfunduar 135 lëndë në shumë prej 4.357.846,00 denarë.

Në vitin 2013 janë regjistruar 123 lëndë në bazë të të drejtës së ndërprerë të pensionit të përkohshëm invalidor në shumë prej 11.036.064,00 denarë prej të cilave kanë përfunduar 36 lëndë në shumë prej 2.206.531,00 denarë, përderisa lëndët e tjera ndodhen në fazën e procedurave gjyqësore para gjykatave kompetente apo ndaj ankesës para Gjykatës Administrative.

Lëndë – dëme në bazë të pagesës së pensionit për shfrytëzuesin e ndjerë janë regjistruar 81 lëndë në shumë prej 2.177.168,00 denarë prej të cilave kanë përfunduar 24 lëndë në shumë prej 333.598,00 denarë.

Në vitin 2013 janë regjistruar 5 lëndë në bazë të stazhit fiktiv në shumë prej 1.634.147,00 denarë që paraqet një reduktim drastik të dëmeve sipas kësaj baze, po qe se merret parasysh se në vitin 2008 sipas kësaj baze janë regjistruar 105 lëndë në shumë prej 37.060.629,00 denarë (prej të cilave 68 lëndë kanë përfunduar – arkivuar në shumë prej 23.787.333,00 denarë).

Në vitin 2013 janë ndërmarrë gjithsej 143 padi (për lëndët nga viti 2013 dhe për një pjesë të lëndëve nga viti 2012 dhe 2011) para gjykatave kompetente në Republikën e Maqedonisë në të cilat Fondi kërkon një shumë prej 48.411.468,00 denarë dhe 65 propozime drejtuar noterëve kompetent për të kryer në bazë të një dokumenti të besueshëm prej të cilëve Fondi kërkon shumë prej 1.708.181,00 denarë.

Në vitin 2013 janë regjistruar 24 padi kundër Fondit të SPIM-së në baza të ndryshme në gjithsej shumë prej 2.116.648,00 denarë prej të cilave 5 lëndë kanë përfunduar në favor të Fondit (shumë prej 312.796,00 denarë), 1 lëndë ka përfunduar në favor të paditësit (109.872,00 denarë), përderisa për lëndët e tjera procedurat gjyqësore ende vazhdojnë.

8. Organet e menaxhimit të Fondit

1. Këshilli drejtues

Këshilli drejtues i Fondit të sigurimit pensional dhe invalidor i Maqedonisë si një organ i menaxhimit në vitin 2013 në mënyrë aktive ka punuar në mbështetje të Programit për punë, Ligjit të sigurimit pensional dhe invalidor, Statutit të Fondit dhe Rregullores për punën e Këshillit drejtues të Fondit. Janë mbajtur gjithsej 22 seanca, u shqyrtuan, diskutuan dhe vlerësuan gjithsej 81 materiale, u sollën gjithsej 17 vendime, është realizuar një aktivitet pune jashtëzakonisht i madh dhe i rëndësishëm dhe janë arritur rezultate nëpërmjet të cilave në vitin 2013 në mënyrë përgjegjëse, kualitative dhe në kohë është realizuar programi për punë.

Puna e Këshillit drejtues në vitin 2013 është ndarë në veprimtaritë e mëposhtme:

- 1) U shqyrtuan dhe miratuan plane dhe programe,
- 2) Diskutim dhe miratimi i raporteve dhe informacioneve për çështje të veçanta në interes të punës së Fondit,
- 3) Vendimet e propozuara dhe të miratuara dhe
- 4) Materiale të shqyrtuara për informimin e drejtpërdrejtë dhe veprimet e ndërmarra nga ndërhyrjet e caktuara aktuale afatshkurtra dhe nevojat për aktivitetet e mëtutjeshme të Fondit.

Në vitin 2013, Këshilli drejtues i Fondit ka mbajtur 22 seanca me gjithsej 81 pikë në rendin e ditës.

- Është shqyrtuar dhe miratuar Programi për punën e Këshillit drejtues të Fondit për vitin 2013.
- Raporti nga regjistrimi i kryer i pronës së plotë të Fondit sikurse në Qendër, filialet dhe ekspoziturat po ashtu edhe prona në shtëpitë për jetesë të shfrytëzuesve të pensionit me të cilat menaxhon Fondi dhe objektet për pushim dhe rekreacion me të cilat disponon Fondi, me gjendje më 31.12.2012.
- Programi për rikonstruimin dhe adaptimin e objekteve afariste të Fondit për vitin 2013.
- Programi për furnizimin e mjeteve themelore dhe pajisjeve informatike në Fond dhe Raporti mbi punën e Fondit për vitin 2012.

- Është përgatitur edhe Statuti i Fondit të sigurimit pensional dhe invalidor si dhe Plani strategjik i Fondit për periudhën prej vitit 2014-2016.
- Buxheti i Fondit për vitin 2014, propozim për ndryshimin dhe plotësimin e Buxhetit të Fondit për vitin 2013 dhe
- Ndryshimet dhe plotësimet e Programit për furnizimin e mjeteve themelore dhe pajisjeve informatike në vitin 2013, ndryshimet e Programit për rikonstruimin dhe adaptimin e objektit të Fondit në vitin 2013 etj.

Gjithashtu, anëtarët e KD-së shqyrtuan dhe miratuan aktivitetet e mëposhtme:

- Informacion mbi shitjet e realizuara të aksioneve dhe pjesëve nga gjithsej kapitali i Fondit të SPIM-së të arritur në bazë të transformimit të ndërmarrjeve me kapital shoqëror me gjendje më 31 Dhjetor të vitit 2013,
- Informacion për realizimin e Programit për rikonstruimin dhe adaptimin e objekteve afariste të Fondit dhe Programi për furnizimin e mjeteve themelore,
- Informacion për lëndët pensionale në baza të ndryshme që janë të regjistruara në Seksionin për punë juridike dhe për të cilat janë marrë apo duhet ndërmarrë veprime procedurale ,
- Informacion për gjendjen me pagesën e qirasë për hapësirën e dhënë banesore në shtëpitë për jetesë dhe klubet e shfrytëzuesve të pensionit për periudhën Janar-Dhjetor të vitit 2013,
- Informacion për gjendjet me pagesën e kontributeve të prapambetura për sigurim pensional dhe invalidor përfundimisht deri më 31.12.2008 si dhe gjendjet aktuale me pagesën e kontributeve për vitin e kaluar 2012,
- Informacion për gjendjen financiare të Fondit për periudhën Janar-Maj të vitit 2013,

- Informacion për zbatimin e Fondit solidar – ndihmë e pas vdekjes për periudhën Janar-Maj të vitit 2013,
- Informacion për shitjet e realizuara të aksioneve dhe pjesëve nga gjithsej kapitali i Fondit i arritur në bazë të transformimit të ndërmarrjeve me kapital shoqëror me gjendje më 24 Qershor të vitit 2013,
- Informacion nga zbatimi i kthimit të mjeteve lidhur me aktgjykimin penal të rastit “Metastaza “,
- Informacion për revizionin e zbatuar të raporteve financiare dhe harmonizimin për vitin 2012 të Fondit nga ana e Entit shtetëror për revizion,
- Informacion për gjendjen financiare të Fondit për periudhën Janar-Qershor të vitit 2013 me vlerësime deri në fund të vitit,
- Raport përfundimtar nga revizioni i zbatuar i raporteve financiare dhe revizioni i harmonizimit në vitin 2012 në Fondin e sigurimit pensional dhe invalidor të Maqedonisë,
- Informacion për gjendjen me pagesën e qirasë për hapësirën e dhënë banesore dhe afariste në shtëpitë për jetesë dhe klubet e shfrytëzuesve të pensionit në periudhën prej muajit Janar deri në Qershor të vitit 2013,
- Informacion për gjendjen financiare të Fondit për periudhën Janar-Shtator të vitit 2013, harmonizimin e pensioneve dhe nivelin e arritur të përfitimeve pensionale në vitin 2013,
- Informacion për shpenzimet transitive në bazë të diversionit të një pjese të kontributeve për sigurim pensional dhe invalidor në fondet pensionale private,
- Informacion për shitjet e realizuara të aksioneve dhe pjesëve nga gjithsej kapitali i Fondit të sigurimit pensional dhe invalidor të Maqedonisë i arritur në bazë të transformimit të ndërmarrjeve me kapital shoqëror në periudhën prej 1 Janarit deri më 25 Dhjetor të vitit 2013 dhe

- Raporti aktuar për sistemin pensional në Republikën e Maqedonisë me projeksione aktuale.

Gjithashtu, Këshilli drejtues miratoi edhe

- Rregulloren për mënyrën e udhëheqjes së evidentimit amë në Fondin e sigurimit pensional dhe invalidor të Maqedonisë dhe
- Udhëzimin për parimet e vetme metodologjike për udhëheqjen e evidentimit amë.

Në seancat e mbajtura gjatë vitit 2013, Këshilli drejtues miratoi këto vendime të rëndësishme:

- Vendim për miratimin e mjeteve financiare për mirëmbajtjen investuese të objekteve afariste të Fondit,
- Vendim për miratimin e Llogarisë përfundimtare të Fondit për vitin 2012,
- Vendim për miratimin e mjeteve financiare për furnizimin e pajisjeve dhe makinave,
- Vendim për emërimin e Komisionit për regjistrimin e pronës së Fondit dhe shtëpive për jetesë si objekte të veçanta ndërtimore dhe klubet për pushim dhe rekreacion të shfrytëzuesve të pensionit me të cilat menaxhon Fondi me gjendje më 31 Dhjetor të vitit 2013,
- Vendim për lartësinë e maksimumit të arkës dhe për pagesën në para të gatshme të Fondit të SPIM-së për vitin 2014,
- Vendime të tjera për subjekte të veçanta juridike të cilat kanë çështje të hapura në bashkëpunim me Fondin e sigurimit pensional dhe invalidor të Maqedonisë etj.

Këshilli drejtues i Fondit në vitin 2013 aktivitetet dhe punën e tij e përqëndroi në zgjidhjen ligjore dhe kualitative të çështjeve aktuale prioritare të kryerjes së veprimtarisë së Fondit, me çka u arritën rezultate të rëndësishme dhe afirmative në këtë fushë.

2. Drejtori

Drejtori i Fondit udhëheq me Fondin dhe e përfaqëson atë para personave të tretë. Në kuadër të autorizimeve të tij në vitin 2013, drejtori me sukses e ka udhëhequr punën e Fondit, gjë e cila kontribuoi në realizimin e rezultateve pozitive në të gjitha segmentet e zbatimit të sigurimit pensional dhe invalidor. Drejtori ka propozuar Programin e punës së Këshillit drejtues për vitin 2013, solli Programin për punën e Fondit dhe është kujdesur për zbatimin e tij. Gjithashtu, ka ndërmarrë më shumë masa për pagesën e kontributit të pa paguar përfundimisht me vitin 2008, ndërsa Qeverisë së Republikës së Maqedonisë i janë dorëzuar më shumë informacione: për rritjen e pagesës së kontributeve për sigurim pensional dhe invalidor, mbi kërkimin e pëlqimit për punësime të reja në vendet e lira të punës, për përmirësimin e kushteve të punës financiare si dhe trajtimin e një sërë çështjeve për kryerjen e veprimtarisë së Fondit të lidhura me regulativën ekzistuese ligjore dhe nevojën për ndryshimin e tyre.

Si rezultat i këtyre aktiviteteve në vitin 2013 është miratuar Ligji për shlyerjen e kamatës në bazë të kontributeve të sigurimit social, është lidhur marrëveshje me Regjistrin qendror të RM-së për marrjen e të dhënave falas për Fondin, për obliguesit deri më 31.12.2014, është miratuar furnizimi i automjetit për terren për nevojat e komisioneve invalidore, është zbatuar ndryshimi dhe plotësimi i Buxhetit të Fondit për vitin 2013, është miratuar Ligji për shlyerjen e kamatës dhe ndryshimet e Ligjit për shoqëritë tregëtare.

Si organ ekzekutiv i Fondit, drejtori i propozoi Këshillit drejtues, raporte, analiza, vendime dhe materiale tjera nga sigurimi pensional dhe invalidor, ndërsa njëkohësisht është kujdesur edhe për zbatimin e vendimeve, udhëzimeve dhe konkluzioneve të sjella nga Këshilli drejtues i Fondit dhe Qeveria e Republikës së Maqedonisë.

Si drejtor i Shërbimit profesional të Fondit organizon dhe koordinon punën e të punësuarve të Fondit dhe vendos për realizimin e të drejtave të tyre nga marrëdhënia e punës.

9. Shërbimi profesional i Fondit

1. Resurset njerëzore

Shërbimi profesional i Fondit në vitin 2013 ka kryer detyrat e punës të parapara me Programin e Këshillit drejtues të Fondit për vitin 2013 dhe detyrat nga zbatimi i sigurimit pensional dhe invalidor si dhe ka vepruar ndaj implementimit të plotë të Ligjit për marrëdhënie pune dhe Ligjit për nëpunësit publik.

Ka vazhduar edhe komunikimi me Agjencinë e Punësimit të RM-së rreth zbatimit të M1-M2 regjistrimetve dhe çregjistrimeve e të punësuarve sipas ç'do baze, përpunimin e raporteve për të punësuarit në lidhje me arsimimin, vendin e punës, kombësinë, gjininë dhe moshën, përpunimin e marrëveshjeve për punë të pavarur dhe të marrëveshjeve për punë vullnetare dhe përgatitjen e aktvendimeve në baza të ndryshme (sistemim, shpërblime, dënime, ndërprerje e marrëdhënies së punës, pushimet vjetore etj.) në mbështetje të Ligjit për marrëdhënie pune.

Gjithashtu, Seksioni në vitin 2013 ka përgatitur edhe përgjigjet në bazë të ankesave të të punësuarve të cilat Fondi ia dorëzonte Agjencisë për Nëpunës Shtetëror, komunikim me Qeverinë dhe me institucione tjera qeveritare, azhurnimin e të dhënave për të punësuarit në koordinim me Fondin e Sigurimit Shëndetësor dhe përpunimin dhe azhurnimin e Planit për mbrojtje në Fond.


Në shërbimin profesional të Fondit, me gjendje në muajin Dhjetor të vitit 2013 ishin angazhuar 654 të punësuar. Në krahasim me vitin 2012 numri është reduktuar për 23 të punësuar për shkak largimit të një numri më të madh të të

punësuarve meqë kishin plotësuar kushtet për pension, ndërsa një pjesë tjetër e të punësuarve kanë lëshuar Fondin për shkak se janë punësuar në vende tjera pune.

Struktura kualifikuese e të punësuarve në Shërbimin profesional të Fondit është e favorshme, përkatësisht më shumë se gjysma e të punësuarve (60,0%) janë me arsim superior dhe arsim të lartë, që mund të vërehet nga pasqyra në vijim:

Tabela nr. 25: Struktura kualifikuese e të punësuarve në Fond

Përgatitja profesionale	2012	Struktura	2013	Struktura
Superiore	310	45,8	314	48,0
E lartë	83	12,3	78	11,9
E mesme	265	39,1	247	37,8
Fillor	19	2,8	15	2,3
Gjithsej	677	100,0	654	100,0



Struktura e të punësuarve sipas përgatitjes arsimore në vitin 2013 në raport të vitit 2012 është rritur vetëm tek përgatitja e lartë profesionale, ndërsa reduktim i vërtetë vërehet tek përgatitjet e tjera profesionale.

Tabela nr.26. Struktura e të punësuarve në Fond sipas gjinisë

Filiale Ekspozitura	Burra		Gra		Gjithsej	
	numri	struktura	numri	struktura	numri	struktura
Berovë	5	71,4	2	28,6	7	100
Manastir	8	32,0	17	68,0	25	100
M. Brod	1	25,0	3	75,0	4	100
Vallandovë	2	50,0	2	50,0	4	100
Veles	7	43,8	9	56,3	16	100
Vinicë	0	0,0	5	100,0	5	100
Gjevgjeli	3	33,3	6	66,7	9	100
Gostivar	10	50,0	10	50,0	20	100
Dibër	3	60,0	2	40,0	5	100
Dellçevë	2	28,6	5	71,4	7	100
D.Hisar	1	25,0	3	75,0	4	100
Kavadar	1	6,7	14	93,3	15	100
Kërçov	2	28,6	5	71,4	7	100
Koçan	2	18,2	9	81,8	11	100
Kratovë	3	75,0	1	25,0	4	100
Kr.Pallankë	3	30,0	7	70,0	10	100
Krushevë	4	57,1	3	42,9	7	100
Kumanovë	12	54,5	10	45,5	22	100
Negotinë	3	33,3	6	66,7	9	100
Ohër	6	40,0	9	60,0	15	100
Prilep	9	45,0	11	55,0	20	100
Probishtip	6	85,7	1	14,3	7	100
Radovish	2	50,0	2	50,0	4	100
Resnjë	4	50,0	4	50,0	8	100
Shën Nikoll	1	12,5	7	87,5	8	100
Strugë	6	42,9	8	57,1	14	100

Strumicë	7	41,2	10	58,8	17	100
Tetovë	20	57,1	15	42,9	35	100
Shtip	11	50,0	11	50,0	22	100
Shkup	28	35,0	52	65,0	80	100
Qendër	92	39,5	141	60,5	233	100
Gjithsej	264	40,37	390	59,63	654	100

Nga të dhënat për të punësuarit sipas gjinisë, vërehet qartë se në Fond dominojnë gratë, të cilat më 31.12.2013 arrijnë 390 apo 59,6% nga gjithsej numri i të punësuarve, ndërsa burrat marrin pjesë me 40,4%.

Tabela nr. 27: Lëvizja e numrit të të punësuarve në Shërbimin profesional të Fondit, në periudhën prej vitit 1995-2013.

Viti	Shërbimi profesional Qendra - Shkup	Njësitë rajonale	Gjithsej
1995	221	409	630
1996	226	409	635
1997	217	404	621
1998	216	395	611
1999	214	406	620
2000	218	407	625
2001	209	415	624
2002	216	419	635
2003	217	406	623
2004	218	389	607
2005	233	423	656
2006	256	448	704
2007	254	430	684
2008	254	462	716
2009	251	427	678
2010	263	474	737
2011	258	451	709
2012	245	432	677
2013	233	421	654

Sipas përgatitjes profesionale bruto paga mesatare (dhjetor , viti 2013) arrin:

PLS	35.788
PL	31.370
PMP	24.860
PUP	20.719
Gjithsej	30.762

Kompensimi i Shërbimit profesional të Fondit në vitin 2013 arrin 257,28 milion denarë dhe i njëjti në gjithsej të dalat e Fond merr pjesë me 0,6%.

2. Raport mbi punën e Njesisë së aktuaristikës në vitin 2013

Në vitin 2013, Njësia e aktuaristikës i kryente obligimet e rregullta të parapara me programin për punë, si dhe të gjitha aktivitetet e paraqitura të jashtëzakonshme.

Në kuadër të obligimeve të rregullta, të punësuarit në këtë Njësi kanë kryer azhurnimin e modelit aktuar i cili shfrytëzohet si një mjet për përgatitjen e projeksioneve afatshurtër, me afat të mesëm dhe afatgjatë për sistemin pensional. Për azhurnimin e modelit, të dhënat për pensionistët dhe të siguruarit si dhe parametrat financiar për punën e Fondit sigurohen nga baza e të dhënave të Fondit dhe Seksioni për koordinimin buxhetor, të dhënat demografike sigurohen nga Enti Shtetëror i Statistikës, ndërsa indikatorët makroekonomik nga Ministria e Financave. Pas azhurnimit të modelit krijohen skenarë të ndryshëm dhe merren rezultatet dalëse mbi parametrat e ndryshëm dhe të rëndësishëm për fushën pensionale.

Me përdorimin e modelit aktuar, Njësia e aktuaristikës gjatë vitit 2013 ka përgatitur skenarë të ndryshëm, llogaritje, analiza dhe parashikime për nevojat e

Fondit, me kërkesë të Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale, Agjencisë së Mbikëqyrjes të sigurimit pensional me financim kapital, Ministrisë së Financave dhe institucioneve tjera të jashtme.

Në fillim të vitit të punësuarit në këtë Njësi me ftesë të Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale, ndërsa në bashkëpunim me Zyrën në Shkup morrën pjesë në konferencën me titull “Procesi i revizionit të strategjisë së zhvillimit demografik 2008-2015 dhe krijimi i masave për politikën e qëndrueshme të popullsisë“. Në këtë konferencë janë prezantuar hapat fillestarë në drejtim të avansimit të strategjisë ekzistuese, është diskutuar për trendet demografike globale dhe kombëtare, politikat e plakjes, politikat e migracionit, planifikimi familjar dhe shëndeti reproduktiv. Konferenca ishte e rëndësishme për anëtarët e Njesisë me qëllim që të zgjerohen njohuritë në fushën e demografisë si një nga parametrat e rëndësishëm në krijimin e parametrave demografik të domosdoshëm për projeksionet e sipërpërmendura.

Me kërkesë të Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale është bërë një analizë e situatës mbi gjendjen me anëtarët dhe pagesat në Shtyllën e dytë. Gjithashtu, për nevojat e Bankës botërore, me kërkesë të Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale janë plotësuar tabela me të dhëna statistikore dhe financiare në fushën e sigurimit pensional dhe invalidor, edhe atë, për periudhën prej vitit 2009-2012.

Përgatitja e projeksioneve për Buxhetin e Fondit në disa skenarë të ndryshëm, për periudhën prej vitit 2014-2016 e cila ka përfshirë edhe rritjen plotësuese të të dalave të pensionit, ishte pjesë e aktiviteteve në këtë periudhë.

Në muajin Korrik, njëri nga anëtarët e Njesisë së aktuaristikës është përfshirë si një anëtarë aktiv në Komisionin e formuar nga ana e drejtorit të përgjirhshëm për të monitoruar dhe përcaktuar punën materiale-financiare të shoqërive tregëtare me përgjegjësi të kufizuar në të cilat Fondi posedon aksione, përkatësisht pjesë dhe procedura falimentuese në të cilat Fondi posedon aksione dhe pjesë. Në mbështetje të aktiviteteve të parashikuara për realizimin e Planit

aksionar, Komisioni përcaktoi gjendjen financiare dhe materiale të 43 Shoqërive aksionare dhe 52 Shoqërive me përgjegjësi të kufizuar ku Fondi i SPIM-së posedon aksione dhe pjesë, së paku 10% pjesëmarrje në pjesën kryesore të të njëjtave. Për rezultatet nga aktivitetet e ndërmarra është përgatitur raport dhe i është dorëzuar Drejtorit.

Si pjesë e aktiviteteve të rregullta, çdo vit, me kërkesë të Agjencisë për mbikëqyrjen e sigurimit pensional me financim kapital për të kryer analiza dhe llogaritjet e tyre personale janë përgatitur dhe dorëzuar projeksione të hollësishme afatgjate aktuale për numrin e anëtarëve, kontributeve të paguara dhe mjetve të akumuluar në Shtyllën e dytë.

3. Puna e Seksionit për revizion të brendshëm

Seksioni për revizion të brendshëm në vitin 2013 detyrat e rregullta të punës, në mbështetje të planit për vitin 2013 i ka kryer me kohë dhe gjithashtu ka kontribuar në përmirësimin e punës në Fondin e sigurimit pensional dhe invalidor të Maqedonisë.

Puna e revizionit të brendshëm është në përputhje me aktet ligjore dhe rregulloret për zbatimin e revizionit të brendshëm dhe standardet ndërkombëtare për revizion të brendshëm, Rregulloren për kodeksin etik të revizorëve të brendshëm dhe akte të tjera. Gjatë çdo revizioni të zbatuar përgatitet dokumentacion i cili përfaqëson një dosje të revizionit me qëllim të një organizimi në zbatimin e tyre.

Revizorët e brendshëm të Seksionit, deri në fund të vitit 2012 dhe në vitin 2013 morrën pjesë në trajnimet për përvetësimin e CIPFA – Certifikatë ndërkombëtare për revizor të autorizuar të brendshëm në sektorin publik, të organizuar nga ana e Institutit të autorizuar të financave publike dhe kontabilitetit (CIPFA) nga

Sllovenia dhe Qendra për zhvillimin e financave (CEF) nga Sllovenia, në bashkëpunim me USAID-in dhe Ministrinë e Financave të Republikës së Maqedonisë.

Pas përfundimit të trajnimit dhe provimeve të kaluara, udhëheqësi i Seksionit për revizion të brendshëm dhe një revizor i brendshëm kanë marrë CIPFA Certifikatë ndërkombëtare për revizor të autorizuar të brendshëm në sektorin publik.

Në vitin 2013 Seksioni ka zbatuar revizionet e mëposhtme:

1. Revizion i sistemit të harmonizimit në procesin e pagesës së Faturës për furnizimin e mallrave dhe shërbimeve.

Me implementimin e rekomandimeve nga ky revizion, sigurohet një zbatim i plotë i sistemit të kontabilitetit dhe librat afarist të kompletuar, të saktë dhe të azhurnuar, sistemi i regjistrimit të dokumenteve të kontabilitetit. Pas përgatitjes dhe implementimit të politikës për kontabilitet në përputhje me regulativën ligjore do të shmangen lëshimet e padëshiruara të të punësuarve në këtë Sektor.

2. Revizion i sistemit të harmonizimit në procesin e evidentimit amë të stazhit të të siguarve të cilët janë shfrytëzues të pensionit me stazh nga sektori privat.

Rreziqet e konstatuara ekzistuese në procesin e rishikuar nuk janë mbuluar nga detyrat e përcaktuara saktësisht, përgjegjësitë dhe kontrollet, ndërsa me implementimin e rekomandimeve nga revizioni i brendshëm është mundësuar mbrojtja e të dhënave të të siguarve në sektorin privat të cilët para tridhjetë e më shumë viteve kanë paguar kontributin e SPI, si dhe mbrojtjen efikase të të dhënave.

3. Revizioni i sistemit, kontrollet e brendshme, që janë përfshirë në aplikacion me zgjidhjen e re të programit për realizimin e të drejtës së pensionit në FSPIM-së.

Sistemi i kontrolleve të brendshme që janë përfshirë në aplikacion me zgjidhjen e re të programit për realizimin e të drejtës së pensionit, është mirë i dizajnuar, funksionon dhe siguron se në të ardhmen do të sigurojë funksionimin e besueshëm të sistemit.

Mundësitë e ofruara nga programi i aplikimit nuk janë nënëpërdorur me implementimin e programit të ri.

Rekomandohet që të përgatitet një plan për trajnime, takime pune dhe shkëmbimin e përvojave në seksionet dhe filialet e Fondit. Revizioni i zbatuar përfaqëson forcimin e lidhjeve të kontrollit në aplikacionin për zgjidhjen e urdhëresës për punë, ndërsa realizimi i të drejtës përkatëse në mbështetje të Ligjit të sigurimit pensional dhe invalidor të mos lihet në përgjegjësinë e referentit për zgjidhjen e të drejtave.

Kontrollet e përforcuara në pranimin dhe regjistrimin e Kërkesës për realizimin e të drejtës të SPI janë përfitimet e këtij revizioni, si dhe formimi i detyrueshëm i dosjes elektronike me të gjitha dokumentet e skanuara e cila është qëllimi kyç i projektit.

4. Revizioni për monitorimin e rekomandimeve të sistemit të kontrolleve të brendshme që janë përfshirë në aplikacion me zgjidhjen e realizimit të së drejtës së pensionit në Fond.

Pas dorëzimit të Raportit përfundimtar nga revizioni, shërbimet profesionale filluan të implementojnë rekomandimet për tejkalimin e parregullsive dhe mangësive të caktuara. Në afat prej dy muajsh janë vendosur kontrolle plotësuese të aplikimit për përzgjidhjen e urdhëresës së punës. Zbatimi jo i barabartë i nenit bazë të ligjit për realizimin e të drejtës së pensionit të pleqërisë u eliminua duke dorëzuar Informacion në filialet mbi një zbatim të barabartë të regulativës ligjore në këtë pjesë, nga ana e Shërbimit profesional të Fondit.

5. Revizion për monitorimin e rekomandimeve të sistemit të kontrolleve të brendshme, të procesit për menaxhimin e incidenteve të sigurisë në sistemin

e informatikës të organizimit dhe raportimi i udhëheqësisë në lidhje me rreziqet ekzistuese në Sektorin e teknologjisë informatike në Fond.

Ky revizion ka përcaktuar 12 konstatime dhe ka paraqitur edhe po aq rekomandime, ndërsa si përfitim më të madh nga revizioni i zbatuar, Seksioni për revizion të brendshëm vlerëson krijimin e procedurave të punës, instalimin e programit për paraqitjen e incidenteve dhe definimin e softuerëve të shërbimit me të cilët punojnë operatorët në sallën e sistemit.

6. Revizioni për monitorimin e rekomandimeve të sistemit të kontrolleve të brendshme të procesit për përcaktimin e cilësisë të të siguarit për kategoritë specifike të të siguarve, bujqve individual dhe kontrollit mbi pagesën e kontributeve të sigurimit pensional dhe invalidor.

Vlerësimi i sistemit të kontrolleve të brendshme të procesit për përcaktimin e cilësisë të të siguarit për bujqit individual në Filialin e Shkupit është se, ai funksionon, por nevojitet përmirësim në dizajnimin e procedurave.

Gjithashtu, është i rëndësishëm fakti që në disa filiale nuk pranohen në sigurim personat të cilët veprimtarinë e tyre e kryejnë në bujqësi dhe për të cilën kanë marrëveshje me koncesion , qira, uzufukt, etj. Kjo dilemë zgjidhet me miratimin e Rregullores për mënyrën e udhëheqjes së evidentimit amë në Fondin e sigurimit pensional dhe invalidor të Maqedonisë (“Gazeta zyrtare e RM-së“ nr. 70/13).

Si një përfitim nga rekomandimet e zbatuara është rezultat i punës së unifikuar në të gjitha filialet dhe ekspoziturat e Fondit për pranimin në sigurim e personave – bujq individual, dosjet e tyre elektronike dhe evidentimi elektronik, si dhe pagesa e borxhit të papaguar të këtyre të siguarve deri në vitin 2008.

7. Revizion i harmonizimit të procesit për regjistrimin, shpërndarjen e postës dhe ekspedimin e akteve të tyre, dokumenteve dhe lëndëve në Fond.

Si një revizion urgjent me kërkesë të Drejtorit të Fondit, në vitin 2013 është realizuar dhe rezulton në përmirësimin e punës në zyrë dhe të arkivit në të gjitha

segmentet e punës brenda një afati të caktuar. Revizioni i brendshëm përcaktoi 7 konstatime dhe paraqiti 10 rekomandime.

Përfitimi për Fondin dhe për të punësuarit është i madh pas automatizimit të punës së plotë të zyrës, me çka do të ekzistojë një version i përhershëm mbrojtës elektronik duke mos pasur nevojë për libër regjistrimi në formë letre, librave interne, kopertinë për shkrimet, etj.

8. Revizion i procesit për pagesën e shpenzimeve të udhëtimit për të punësuarit në Qendrën e Fondit.

Nga revizioni i zbatuar dhe aktivitetet e ndërmarra nga inspektimi i dokumenteve të kontabilitetit, testimet si dhe nga bisedimet me personat përgjegjës, Revizioni i brendshëm konstatoi se për procesin e reviduar është vendosur një sistem kompleks i kontrolleve interne i cili e redukton rrezikun e shpenzimeve të pasynuara dhe të paligjshme të mjeteve nga Buxheti i Fondit të SPIM-së.

Për thjeshtësimin e procedurës dhe evidentimin ditor të kilometrave të kaluara dhe karburantit të shpenzuar, është rekomanduar që të ndryshohet dhe plotësohet "Udhëzim për kushtet dhe mënyrën e shfrytëzimit të automjeteve zyrtare të Fondit në Vend dhe jashtë Vendit, i njëjti të respektohet plotësisht nga të gjithë të involvuarit në këtë proces.

9. Përgatitje e raporteve katërmujorëshe mbi rekomandimet e zbatuara.
10. Përgatitje e raporteve dhe deklaratat e gjendjes së cilësisë së kontrolleve të brendshme nga Raporti vjetor financiar, në mbështetje të Ligjit për kontrollin e brendshëm financiar publik ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë "nr. 90/09).
11. Përgatitje e Planit vjetor dhe strategjik të Seksionit për revizion të brendshëm.
12. Pjesëmarrje në zbatimin e rekomandimeve për implementimin e ISSO standardeve.

13. Pjesëmarrje në përgatitjen e Planit strategjik të Fondit, viti 2014-2016.

4. Kontrolli buxhetor

Në Seksionin e kontrollit buxhetor në vitin 2013 në tërësi janë realizuar të gjitha detyrat e parapara me Programin mbi punën dhe me Planin për zbatimin e kontrolleve financiare në Fondin e sigurimit pensional dhe invalidor të Maqedonisë.

- Ex-ante dhe Ex-post kontrolli i të gjitha marrëveshjeve të lidhura financiare të Fondit me institucionet e tjera dhe e ndiqte realizimin e tyre;
- Të gjitha faturat hyrëse gjatë së cilave është kryer kontrolli i të njëjtave, para se të bëhej pagesa;
- Kontrolli i të gjitha faturave gjatë pagesës së mjeteve për të gjitha Njësitë rajonale të Fondit për pagesën e mjeteve materiale, me çka jepte instruksione për inkosekuencë (pospërputhshmëri);
- Kontrole në pjesën e punës financiare në disa seksione ku janë konstatuar lëshime të caktuara procedurale dhe të cilat në bazë të paraqitjeve tona janë mënjanuar;
- Monitorimi i rregullt dhe informimi i Ekipit të menaxhimit për zbatimin e buxhetit;
- Shpërndarja e brendshme e buxhetit në mbështetje të LKBPF (Ligji për kontrollin e brendshëm publik financiar);
- Përgatitja e raporteve dhe Deklaratës për cilësinë dhe gjendjen e kontrolleve të brendshme nga Raporti vjetor financiar;
- Përpunimi i Planin strategjik për zbatimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit;
- Përpunimi i Planit për krijimin dhe zhvillimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit (Metodologjia për zbatimin e planit);

- Përgatitja e raporteve gjashtë mujore për Komisionin shtetëror mbi parandalimin e korrupsionit;
- Kontrolli i rregullt i pagave dhe të dalave ditore.

Me rekomandimin e Entit shtetëror për revizion, në mënyrë aktive ka marrë pjesë në përgatitjen e procedurave të shkruara në Sektorin e çështjeve financiare, ka marrë pjesë në zbatimin e rekomandimeve për implementimin e ISSO standardeve me çka Fondi ka fituar një certifikatë për ISSO 9001:2008 standardin e implementuar.

Gjatë vitit 2013 ky Seksion ka zbatuar kontroll në Seksionin për pagesën e pensioneve dhe ka konstatuar se është e nevojshme të kryhet kontrolli i shfrytëzuesve të pensionit sipas vendbanimit në Republikën e Maqedonisë, nëse ata jetojnë. Në këtë drejtim, në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe Ministrinë e Drejtësisë është bërë ko incidimi i të dhënave për shfrytëzuesit e pensionit. Në mbështetje të nenit 141 të Ligjit për sigurim pensional dhe invalidor, ndërsa lidhur me bashkëpunimin me Drejtorinë për Udhëheqjen e Librave Amë janë kontrolluar 2874 pensionistë të moshës mbi 90 vjet, me qëllim që të përcaktohet nëse të gjithë janë pensionistë aktiv dhe është konstatuar se 20 pensionistë kanë vdekur për të cilët janë inicuar veprime të mëtejshme.

Seksioni, gjithashtu veproi mbi shkresën nga Ministria e Financave, Drejtoria e Policisë Financiare dhe me shkrim i është drejtuar bankave afariste me një kërkesë për kthimin e mjeteve nga shfrytëzuesit e ndjerë të pensionit. Me këtë aktivitet janë kthyer mjete në shumë prej 3.010.000,00 denarë.

Seksioni për kontrollin buxhetor rekomandoi që të zbatohen procedurat e përshkruara nga ana e të gjithë kompetentëve në sektorë dhe seksione.

5. Furnizimet publike

Në vitin 2013 në Fond janë zbatuar të gjitha furnizimet publike në mbështetje të Ligjit për furnizime publike dhe Planit për furnizime publike për vitin 2013.

Procedurat për dhënien e kontratave për furnizime publike janë udhëhequr me:

- procedurën me kërkesë për grumbullimin e ofertave me dhe pa shpallje kur vlera e parashikuar e Marrëveshjes për furnizime publike pa TVSH arrin deri më 5.000 Euro në kundërvlerë denarë për mallra, shërbime dhe punë,
- procedurë me kërkesë për grumbullimin e ofertave me shpallje kur vlera e parashikuar e Marrëveshjes për furnizime publike të mallrave dhe shërbimeve arrin deri më 20.000 Euro, pa TVSH-në në kundërvlerë denarë, ndërsa për punët deri më 50,000 Euro pa TVSH-në në kundërvlerë denarë,
- procedurë e hapur nëse vlera e Marrëveshjes për furnizime publike arrinte 130,000 Euro (përkatësisht 200,000 Euro për punë të caktuara) në kundërvlerë denarë për mallra dhe shërbime dhe 4.000.000 Euro në kundërvlerë denarë për punët pa TVSH-në dhe procedurë me negociim pa shpallje paraprake.

Në vitin 2013 nga ana e Fondit ishin publikuar 51 shpallje për ndarjen e marrëveshjeve për furnizime publike prej të cilave 19 shpallje janë për grumbullimin e ofertave me vlerën e parashikuar prej 5.000 Euro në kundërvlerë denarë për mallra, shërbime dhe punë në mbështetje të ndryshimeve të reja ligjore për një shpallje të detyrueshme të procedurës së llojit të tillë prej qershorit të vitit 2013, 13 shpallje për grumbullimin e ofertave me shpallje me vlerën e çmuar të marrëveshjes deri më 20.000 Euro në kundërvlerë denarë për mallra, shërbime dhe punë, 18 shpallje me procedurë të hapur për grumbullimin e ofertave për furnizimin e mallrave, shërbimeve dhe punë mbi 130.000 Euro në kundërvlerë denarë, 8 ftesa të dorëzuara për ndarjen e Marrëveshjes për furnizime publike pa shpallje dhe 1 procedurë eështë udhëhequr në shpallje tjera si “të tjera“ apo “shërbime jo prioritare“ në mbështetje të nenit 17 paragrafi 1 alineja 2 dhe paragrafi 2 dhe 3 nga neni i njëjtë i Ligjit për furnizime publike.

Fondi në vitin 2013 ka lidhur gjithsej 57 marrëveshje edhe atë 20 marrëveshje me procedurë të hapur, 16 marrëveshje me kërkesë për grumbullimin e ofertave, 12 marrëveshje me kërkesë për grumbullimin e ofertave me shpallje, 8 marrëveshje me procedurë me negociata pa publikimin e shpalljes dhe 1 marrëveshje për furnizimin e shërbimeve nga neni 17 paragrafi 1 alineja 2 dhe paragrafi 3 nga neni i njëjtë i Ligjit për furnizime publike.

Të gjitha marrëveshjet e lidhura për furnizime publike janë shpallur në SEFP (sistemi elektronik për furnizime publike) <http://e-nabavki.gov.mk> dhe janë në dispozicion të publikut.

Në vitin 2013 janë asgjësuar 12 procedura për ndarjen e Marrëveshjes për furnizime publike. Procedurat janë asgjësuar për shkak arsyeve të mëposhtme:

- nuk është dorëzuar as edhe një ofertë e duhur apo e pranueshme,
- nuk është dorëzuar as edhe një ofertë dhe
- ofruesit, ofruan një çmim dhe kushte për zbatimin e Marrëveshjes për furnizime publike të cilat janë më pak të favorshme nga ato realet në tregun aktual.

Gjatë zbatimit të procedurës për ndarjen e marrëveshjeve për furnizime publike me mjete elektronike (nëpërmjet SEFP), të gjitha veprimet në procedurë (publikimi i shpalljeve, dokumentacioni i tenderit, dorëzimi i ofertave, hapje publike, vlerësimi i ofertave, caktimi i e-ankandeve, sjellja e vendimeve, njoftime rreth vendimeve të sjella, njoftim për marrëveshje të lidhur, evidencë e procedurave me kërkesën për grumbullimin e ofertave dhe komunikimi me operatorët ekonomik) zbatohen në formë elektronike me të cilën mundësohet një konkurrencë më e madhe ndërmjet operatorëve ekonomik, trajtimit të barabartë dhe mos diskriminimit të operatorëve ekonomik, transparencës dhe integritetit në procesin e ndarjes së marrëveshjeve për furnizime publike.

Në vitin 2013 janë caktuar 32 ankande elektronike dhe 8 mbledhje për negociim të cilat me sukses janë zbatuar (ofruesit licituan me çmimet) dhe është realizuar

kursim i mjeteve sikurse në çmim ashtu edhe në shpenzimet gjatë zbatimit të furnizimeve.

Në procedurat për furnizime publike nga ana e operatorëve ekonomik janë dorëzuar gjithsej 4 ankesa deri te Komisioni për furnizime publike pranë Fondit, të cilave ankesa gjithashtu u është përgjigjur Komisioni i njëjtë dhe të njëjtat ia dorëzoi Komisionit shtetëror për ankesë sipas furnizimeve publike.

Nga gjithsej ankesat e dorëzuara, Komisioni shtetëror për ankesa sipas furnizimeve publike, hodhi poshtë 2 ankesa si të pa baza dhe për një procedurë solli Vendim për anulimin e procedurës.

6. Fondi solidar

Në mbështetje të nenit 115 nga Ligji i sigurimit pensional dhe invalidor, shfrytëzuesit të pensionit me pëlqimin e tij i ndalohet një shumë e caktuar nga pensioni me qëllim që të sigurojë mjete të nevojshme për pagesën e ndihmës së pas vdekjes për familjarët e tij dhe për anëtarësim në Shoqatën e pensionistëve (anëtarësi).

Në mbështetje të Vendimit të organizatës së regjistruar nga Lidhja e pensionistëve për vitin 2013 shuma e ndihmës së pas vdekjes arrin 120 denarë, ndërsa anëtarësimi 30 denar në muaj.

Ndihma e pas vdekjes për shfrytëzuesit e ndjerë të pensionit në vitin 2013 arrin 30.000 denarë.

Në vitin 2013 nga shfrytëzuesit e pensionit për Fondin solidar – ndihmë e pas vdekjes janë mbajtur mjete në shumë prej 392.031.120 denarë, derisa anëtarëve të familjeve të 13.374 shfrytëzuesve të ndjerë të pensionit u janë paguar mjete në shumë prej 401.220.000 denarë.

Tabela nr. 28. Lëvizja e mjeteve të ndara dhe mjeteve të paguara për Fondin solidar -ndihmë e pas vdekjes nga shfrytëzuesit e pensionit, sipas muajve në vitin 2013

Muaj	Shfrytëzues të pensionit	Fondi solidar	Të ndjerë	Mjete të paguara
Janar	269.449	32.333.880	1472	44.160.000
Shkurt	269.928	32.391.360	1111	33.330.000
Mars	270.544	32.465.280	1122	33.660.000
Prill	271.223	32.546.760	1077	32.310.000
Maj	271.959	32.635.080	1048	31.440.000
Qershor	272.209	32.665.080	1079	32.370.000
Korrik	272.220	32.666.400	1140	34.200.000
Gusht	272.775	32.733.000	998	29.940.000
Shtator	273.012	32.761.440	994	29.820.000
Tetor	273.543	32.825.160	1077	32.310.000
Nëntor	274.751	32.970.120	1122	33.660.000
Dhjetor	275.313	33.037.560	1134	34.020.000
Gjithsej		392.031.120	13.374	401.220.000

Mjetet e ndara për ndihmë të pas vdekjes në shumë prej 392.031.120 denarë në raport të mjeteve të paguara në shumë prej 401.220.000 denarë janë më të ulëta për 9.188.880 denarë, që tregon se mjetet e paguara për vitin 2013 nuk janë plotësisht të mbuluara me mjetet e ndara për këtë qëllim, ndërsa janë shfrytëzuar mjete nga saldo-ja e mjeteve më 31.12.2012.

Në periudhën prej vitit 2010 deri në vitin 2013 mjetet e ndara dhe të paguara për ndihmë të pas vdekjes arrijnë, edhe atë:

Tabela nr.29:

Viti	Mesatarja e shfrytëzuesve	Mjete të ndara	Shfrytëzues të ndjerë	Mjete të paguara
2010	262.370	377.910.674	12.617	378.501.162
2011	262.179	377.587.680	13.112	393.360.000
2012	265.764	382.711.152	13.219	396.570.000
2013	272.243	392.031.120	13.374	401.220.000

Numri i shfrytëzuesve të ndjerë të pensionit në vitin 2013 arrin 13.374 shfrytëzues, ndërsa në vitin 2010 arrin 12.617 shfrytëzues të ndjerë. Në raport të vitit 2010 numri i shfrytëzuesve të ndjerë në vitin 2013 është rritur për 757, ndërsa në krahasim me vitin 2012 për 155 shfrytëzues.

Në vitin 2013 numri i shfrytëzuesve të ndjerë të pensionit arrin 13.374 shfrytëzues apo në mesataren mujore 1114 shfrytëzues.

Lëvizja sipas muajve e shfrytëzuesve të ndjerë të pensionit është paraqitur në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr. 30: Numri i shfrytëzuesve të ndjerë të pensionit në vitin 2013 sipas muajve:

Muaj	Shfrytëzues të ndjerë
Janar	1472
Shkurt	1111
Mars	1122
Prill	1077
Maj	1048
Qershor	1079
Korrik	1140
Gusht	998
Shtator	994
Tetor	1077

Nëntor	1122
Dhjetor	1134
Gjithsej	13.374

Nga tabela shihet se vdekshmëria e shfrytëzuesve të pensionit ndryshon sipas muajve, përjashtohet muaji Dhjetor ku numri më i madh i përfituesve të ndjerë arrin deri në 1.472 të ndjerë për një muaj, ndërsa më i vogël është në Shtator dhe arrin 994 shfrytëzues të ndjerë të pensionit.

Shërbimi profesional i Fondit në vitin 2013 kryente pagesë të rregullt të ndihmës së pas vdekjes për familjarët e shfrytëzuesve të ndjerë.

10. Sistemi i informatikës

Teknologjia informatike dhe e komunikimit është njëri nga elementet themelore për një zbatim efikas dhe efektiv të sigurimit pensional dhe invalidor. Pajisja informatike është bartëse dhe lidhje themelore për realizimin e proceseve afariste në të gjitha segmentet e punës së Fondit të sigurimit pensional dhe invalidor të Maqedonisë.

Në vitin 2013 në Seksionin për Softuerin aplikativ në mënyrë të vazhdueshme është punuar në mirëmbajtjen dhe përsosmërinë e të gjitha linjave ekzistuese, aktvendimet aplikative për përkrahjen e proceseve afariste për kryerjen e aktiviteteve aktuale në Shërbimin profesional të Fondit.

Në pjesën e regjistrimit të obliguesve dhe të të siguruarve janë bërë aktivitetet në vazhdim:

- Ndryshime dhe plotësime të rregullta të softuerit për regjistrimin e të siguruarve dhe obliguesve në mbështetje të ndryshimeve ligjore, vendime të Qeverisë apo kërkesa tjera,
- Sigurimi i azhurnimit ditor të regjistrit të obliguesve dhe të të siguruarve,

- Gjenerimi dhe përcaktimi i të dhënave vjetore për stazhin e përcaktuar dhe pagat e realizuara si dhe kompensimet,
- Është përgatitur zgjidhje e softuerit për gjenerimin, kontrollin automatik, zbulimin dhe selektimin e gabimeve të të dhënave vjetore për stazhin e përcaktuar dhe pagat e realizuara të kompensimeve,
- Në pjesën e Evidentimit amë, shfrytëzuesve të së drejtës dhe pagesës së përfitimeve pensionale sipas gjitha bazave,
- Gjatë vitit 2013 është bërë një analizë e problemeve të paraqitura nga shfrytëzuesit e softuerit në pjesën e zgjidhjes të së drejtës nga SPI dhe pagesës së përfitimeve pensionale,
- Mirëmbajtje dhe riparim i zgjidhjes së softuerit të orakl platformës në pjesën e evidentimit amë të shfrytëzuesve të së drejtës dhe pagesës së përfitimeve pensionale,
- Ndryshime dhe plotësime të rregullta të softuerit të shfrytëzuesve të pensionit të së drejtës dhe pagesës së përfitimeve pensionale në mbështetje të ndryshimeve ligjore, vendime të Qeverisë apo kërkesa tjera.

Në pjesën e Vlerësimit të aftësisë për punë:

- Analizë dhe përkrahje e softuerit për vlerësimin e aftësisë për punë,
- Përgatitje të pasqyrave të ndryshme statistikore dhe raporteve për nevojat e shërbimeve të Fondit,
- Mirëmbajtje të aktvendimeve aplikative për shërbimin e pagesës së Fondit solidar nëpërmjet Fondit (mjete për ndihmë të pas vdekjes të cilat paguhen për trashëgimtarët e shfrytëzuesve të ndjerë të pensionit për të cilët në pagesat mujore të përfitimeve pensionale është bërë mbajtje lidhur me këtë qëllim).

Pjesëmarrje në implementimin e projektit për digjitalizimin e regjistrave të vjetër mikrofilmike të M1, M2, M3, M4, M5, M6, M7, M8 dhe PS formularëve dhe migrimi i shënimeve të vjetra mikrofilmike nga RMS dadoteka në VMS sistemin operativ ORACLE.

Në vitin 2013 detyrë me prioritet në Seksionin e Zhvillimit të sistemit të informatikës është që të sigurojë shpërndarjen e rregullt të pagesave të kontributeve të cilat çdo ditë mbërrijnë në llogarinë kalimtare me të cilën menaxhon Fondi, përmes menaxhimit të të dhënave për pagesat e dërguara nga trezori me të dhëna për LLMPI fletëparaqitjeve të paguara të cilat i dërgon Drejtoria e të Hyrave Publike për kryerjen e procesit mbi shpërndarjen e pagesave dhe të dhënave ndërmjet FSPIM-së dhe fondeve pensionale private, me kontroll dhe përcaktim nga Agjencia për supervizion i sigurimit pensional me financim kapital, që pastaj të shpërndahet një pjesë e parave në llogarinë institucionale të Fondit, ndërsa një pjesë në fondet pensionale private. Përveç parave shpërndahen edhe të dhënat për çdo person.

Gjatë vitit 2013 janë bërë aktivitetet në vazhdim:

- Zgjidhje e pagesave problematike në koordinim me Seksionin për kontrollin e të dhënave nga kontributi i sigurimit pensional dhe invalidor, të dhëna për LLMPI fletëparaqitjet me të cilat kontrollohen në Drejtorinë e të Hyrave Publike dhe pastaj merren prej andej.
- Automatizim i pjesëve nga procesi për kthimin e mjeteve. Procesi në një sistem të caktuar është i automatizuar, por qëllimi i këtij sistemimi është që procesi të jetë drejtpërdrejt i kontrolluar edhe nga Njësia afariste për pagesën e kontributeve.
- Përkrahje informatike për tejkalimin e problemeve që paraqiten gjatë gjenerimit ndërsa aktvendimet për obliguesit të të cilët ka pasuar ndryshimi i të dhënave në sistemin e pagesës së kontributeve.

- Detyra aktuale, mirëmbajtje të aplikacioneve me të gjitha veçoritë e saja që dalin nga definicionet afariste, teknologjia e informatikës dhe zgjidhja e programit.
- Sigurimi i projekteve të reja dhe aktvendimet aplikative me Fondin e sigurimit shëndetësor dhe përmes një komunikimi me Ueb serverët, me çka, Fondi i paraqet ndryshimet për statuset e pensionistëve të nevojshëm për FSSH-së në procesin e sigurimit shëndetësor të pensionistëve.

Në vitin 2013, Seksioni për Sistemin e inxhinierisë dhe komunikimit me sukses ka implementuar dhe realizuar aktivitetet në vijim:

- Zgjerimin e hapësirës së IMB system storage DS4800 model 88 duke shtuar disqet e forta dhe zgjerimin e RAM - memories të blade serverëve ku është instaluar VMWARE,

- Implementim i propozimeve nga Projekti për depërtimin e rrjetit të Fondit.
- Instalim të Softuerit për menaxhim qendror të serverëve dhe kompjuterëve.
- Instalim të Microsoft Exchange 2010
- Instalim dhe konfigurim të dikaster center – Përmirësim të shpejtësisë të Metro Eternetit dhe aktivizimin e VPN me instalim të ruterit.
- Furnizim dhe instalim të Rack 42U për njësitë rajonale mbi vendosjen e pajisjes së instaluar (dokumentacioni i tenderit, procedura, instalimi).

11. Ekonomizim me pronën e Fondit

Në vitin 2013, Seksioni për ekonomizim me pronën e Fondit, ndërmori një sërë aktivitetesh në lidhje me kompetencat e tij dhe obligimet në mbështetje të Programit për punën e miratuar nga Këshilli drejtues mbi funksionimin kualitativ

të shtëpive për jetesë të shfrytëzuesve të pensionit, ekonomizim me hapësirën banesore dhe afariste, zbatimin e Programit për rikonstruimin, adaptimin dhe mirëmbajtjen investuese të objekteve të Fondit sikurse në filialet dhe Qendrën ashtu edhe në një pjesë të shtëpive të pensionistëve, dhënien e objekteve për pushim dhe rekreacion për të punësuarit në Fond, sigurimin e dokumentacionit të nevojshëm për regjistrimin e objekteve në pronësi të Fondit në evidencën e kadastërit dhe marrjen e fletë pronësive.

Nga gjithsej 37 shtëpitë për jetesë të shfrytëzuesve të pensionit në Vend, Fondi deri më 31.12.2012 ekonomizoi me 14 shtëpi për vendosjen e shfrytëzuesve të pensionit, ndërsa prej 26.07.2013 është marr edhe Shtëpia në Kumanovë, kështu që tani ekonomizon me 15 shtëpi të pensionistëve të cilat disponojnë me 406 njësi banesore me 451 shfrytëzues të vendosur të pensionit. Apartamente të lira ka 2 në shtëpinë e pensionistëve Shën Nikoll sepse nuk ka kërkesë nga shfrytëzuesit e pensionit të cilët i plotësojnë kushtet për vendosje dhe në Gostivar sepse janë marr masa të përkohshme për shkak padisë nga ana e Shoqatës së pensionistëve nga Gostivari. Qiraja paguhet rregullisht nëpërmjet mbajtjes së një shume të caktuar nga pensioni, ndërsa shpenzimet tjera (shërbimet komunale) paguhen me më pak vështirësi. Huamarrja totale për vitin 2013 arrin 3.770.032,00 denarë, ndërsa totali i mjeteve të paguara nga qiratë e shfrytëzuesve të pensionit arrin shumë prej 3.702.838,00 denarë, apo 98.22% pagesë.

Me lirim e apartamenteve në Shtëpitë për jetesë të shfrytëzuesve të pensionit, në mbështetje të Shpalljes dhe vendimeve të sjella nga komisionet, në Filialet lidhen marrëveshje me shfrytëzues të rinj dhe plotësohen njësitë e lira banesore. Në vitin 2013 janë lidhur gjithsej 46 marrëveshje të reja në të gjitha shtëpitë në Vend. Shtëpitë mirëmbahen rregullisht dhe gjithashtu janë krijuar kushte të mira për jetesë të shfrytëzuesve të pensionit.

Fondi në shtëpitë për jetesë të shfrytëzuesve të pensionit disponon me hapësirë afariste prej 8.407,13 m² prej së cilës 5.788,49 m² është dhënë, ndërsa 2.616,64 m²

nuk është dhënë me qira. Për dhënien e hapësirës afariste me qira publikohet shpallje, ndërsa një Komision i veçantë nga Fondi bën zgjedhjen për dhënien e të njëjtit, pas vendimit të sjell për zgjedhje, atëherë kur lidhet Marrëveshje dhe e njëjta jepet me qira. Në vitin 2013 janë lidhur 8 marrëveshje të reja për dhënien e hapësirës afariste me qira.

Në vitin 2013 Fondi në emër qira për hapësirë afariste ka faturuar 12.587.887,00 denarë dhe ka paguar 12.241.745,00 denarë apo pagesa aktuale është 97,25%, që është në nivel të njëjtë në krahasim me vitin paraprak.

Në këtë periudhë nga gjithsej kërkesat e bartura nga periudha paraprake në shumë prej 514.075,00 denarë, janë paguar 419.529,00 denarë apo 87,75% nga kërkesat e bartura.

Në periudhën e njëjtë është llogaritur edhe kamatë detyruese për pagesën e vonuar në shumë prej 46.471,00,00 denarë dhe është paguar 35.665,00 apo 76,75%. Për përmirësimin e pagesës, qiraxhinjtë ishin paralajmëruar lidhur me vonimin e pagesës, me çka parandalohet inicimi i padive për qiramarrësit jo të rregullt dhe ndërprerja e Marrëveshjes për qira.

Në vitin 2013 me dhënien e objekteve për pushim dhe rekreacion me të cilat disponon Fondi, në mbështetje me kërkesat e parashtruara janë realizuar 737 netë nga ana e të punësuarve në Fond. Për shkak kushteve të përmirësuara në këto pushimore mund të konstatohet se, çdo vit rritet numri i të punësuarve të cilët i shfrytëzojnë pushimoret e Fondit.

Në vitin 2013 Seksioni kishte rritur aktivitetet edhe rreth azhurnimit të dokumentacionit për regjistrimin e pronës së Fondit në Agjencinë e kadastërit të patundshmërive. Elaboratet e dorëzuara gjeodete në Ministrinë e Transportit dhe Lidhjeve për zbatimin e procedurës në mbështetje të Ligjit për trajtimin e ndërtimeve pa leje janë në fazën përfundimtare, kështu që në vitin 2014 pritet të përfundojnë të gjitha procedurat dhe në këtë mënyrë do të rregullohen marrëdhëniet pronëso-ro-juridike me të cilat disponon Fondi.

Investimet në vitin 2013

Në vitin 2013 janë bërë aktivitete investuese në kuadër të mjeteve të parapara me Buxhetin e Fondit për vitin 2013 me qëllim që të përmirësohen kushtet për punën e të punësuarve edhe në shtëpitë për qëndrim të shfrytëzuesve të pensionit.

- Filialet dhe ekspoziturat

Janë bërë më shumë orvatje investuese në filialet dhe ekspoziturat:

Në Qendër, në Shkup, është bërë ndërrimi i mburrojave të teracave në katin e katërt me një mburrojë të re nga plastika e shkrirë.

Në Delçevë, në hapësirat e reja është bërë rikonstruim me një përpunim, përkatësisht ndërtimi i ngrohjes qendrore dhe janë mundësuar kushtet e plota për punë.

- Shtëpitë për jetesë

Në shtëpitë për jetesë të shfrytëzuesve të pensionit në vitin 2013 ka vazhduar investimi në përmirësimin e kushteve për vendosjen e shfrytëzuesve të pensionit.

Në shtëpinë për jetesë të shfrytëzuesve të pensionit në Gjorçe Petrov është bërë ndërrimi i PVC roletneve mbrojtëse, me të reja, në të gjitha njësitë banesore, me çka është përmirësuar efikasiteti i energjisë dhe janë reduktuar shpenzimet për ngrohje dhe ftohje. Janë blerë edhe panelet për ngrohjen e njësisive banesore.

Në shtëpinë për jetesë të shfrytëzuesve të pensionit në Kriva Pallankë është bërë ndërrimi i kulmit mbi njësitë e banimit me një mbulesë të re plastike. Janë ndërruar edhe portalet e vjetëruara të shkallëve me PVC të reja, gjithashtu është bërë edhe lyerja e hapësirës së shkallëve.

Në shtëpinë për jetesë të shfrytëzuesve të pensionit në Çair e cila është marrë në vitin 2012, janë kryer punët artizanate për përmirësimin e kushteve për jetesë, me çka janë ndërruar dritaret dhe dyert e jashtme në hapësirat e përbashkëta, është bërë riparimi i instalimit elektrik si dhe ndërrimi i një pjese më të madhe të mbulesës së kulmit nga saloniti me një mbulesë të re nga plastika e shkrirë.

Me këto investime në mënyrë të konsiderueshme janë përmirësuar kushtet për jetesë të shfrytëzuesve të pensionit në shtëpitë e pensionistëve me të cilat menaxhon Fondi i cili edhe më tutje do të vazhdojë me aktivitetet mbi investimin në shtëpitë, në kuadër të mjeteve të caktuara me Buxhetin për këtë synim.

VI. PËRFUNDIM

Raporti vjetor për punën e Fondit për vitin 2013, sistematikisht dhe në mënyrë të detajuar e paraqet realizimin e të gjitha funksioneve të rëndësishme të zbatimit të sigurimit pensional dhe invalidor të shprehura nëpërmjet treguesve të shumtë statistikor dhe treguesve të tjerë.

Pjesa hyrëse në formë të shkurtër i paraqet aktivitetet e rëndësishme të Fondit në vitin 2013, ndërsa në vazhdim të Raportit në mënyrë krahasuese dhe në mënyrë analitike janë shfaqur rezultatet e realizuara.

Me të hyrat e realizuara në vitin 2013 dhe mjetet e bartura monetare nga viti 2012, Fondi rregullisht dhe në kohë të duhur i kryente obligimet ndaj shfrytëzuesve të pensionit dhe obligimet tjera.

Fondi punën e tij në vitin 2013 e ka kryer me sukses dhe në mënyrë efikase, gjë e cila rrjedh nga të dhënat e detajuara për kryerjen e detyrave.

Të siguruarit dhe shfrytëzuesit e pensionit pa pengesë kanë realizuar të drejtat e tyre në Fond, në mbështetje të Ligjit, Statutit dhe aktet e tjera të përgjithshme të Fondit.

Fondi pagesën e pensioneve e ka kryer rregullisht në afatet e parapara, si dhe realizoi harmonizim të rregullt dhe plotësues të pensioneve në mbështetje me dispozitat ligjore.

* *

*

Këshilli drejtues i Fondit, në seancën e mbajtur më _____ të vitit 2014 miratoi Raportin për punën e Fondit në vitin 2013.

Drejtor i Fondit,
Bekim Neziri

Kryetar i Këshillit Drejtues të
Fondit,
Aco Stojanov

Shkup, Maj 2014